



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS - MUNICIPALITY OF PEJA - OPŠTINA PEĆ



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

Nr. Protokolit: 060/01-2956

Data: 16.04.2024

Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

**THËRRET**

Të merrni pjesë në mbledhjen e IV të rregulltë për vitin 2024, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 26.04.2024 (Premte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

*Vërejtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.*

**RENDI I DITËS**

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 28.03.2024.
4. Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik i Plani Lokal i Veprimtimit në Mjedis 2024-2028.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit të tejkalimit të planit të të hyrave.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i bartjes dhe rialokimit të mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".
8. Shqyrtimi i informatës mbi listen e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.
9. Shqyrtimi i raportit mbi funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.
10. Shqyrtimi i informatës tremujore financiare (janar –mars 2024) të Komunës së Pejës.
11. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar (për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Ejten me dt. 25 Prill 2024).
12. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS  
Adresa: Rr. Hasan Prishtina  
Tel: 03820043433





## SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

**Br. Protokola: 060/01-29756**

**Datum: 16.04.2024. godine**

**Za: Članove Skupštine Opštine Peć**

Poštovani članovi/članice,

Na osnovu člana 43, stav 43.1. Zakona o Lokalnoj Samoupravi, člana 28, stav 1 Statuta br.01-2020 Opštine Peć i na osnovu člana 11, stav 1.2, člana 1.5 stav 1 Pravilnika o Radu br.02-2021 Skupštine Peć, Predsedavajući Skupštine vas:

### POZIVA

Da učestvujete na IV redovnoj sednici Skupštine Opštine Peć za 2024. Godinu. Sednica će se održati dana 26.04.2024 (petak), u 10:00 časova, u sali Skupštine Opštine Peć.

*Napomena: Komitet za Politiku i Finansije zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.*

### DNEVNI RED

1. Učešće i odsustvo članova na sednici.
2. Učešće javnosti i delegacija.
3. Razmatranje i usvajanje zapisnika Skupštine Opštine od 28.03.2024.
4. Razmatranje i prepruka za davanje na javnu raspravu Lokalnog Akcionog Plana za Sredinu 2024-2028.
5. Razmatranje i preporuka premašivanja budžeta i plana prihoda.
6. Prenos (realokacija) nepotrošenih budžetskih sredstava iz 2033. Godine u 2024. Godinu.
7. Razmatranje i usvajanje odluke o projektu "Podrška farmerima/poljoprivrednicima u ruralnim zonama u vidu poljoprivrednih mašina".
8. Informacije o listama opštinske imovine i upravljanje njima.
9. Razmatranje informacija o funkcionisanju lokalnih odbora u Opštini Peć.
10. Razmatranje finansijskih informacija Opštine Peć za tromesečni period (januar –mart 2024).
11. Pitanja i predlozi u vezi rada Opštine Peć, istaknuti od članova, po redosledu po kome su primljeni (dostaviti sekretaru ne kasnije od četvrtka, dana 25. Aprila 2024).
12. Pitanja istaknuta od strane predsedavajućeg ili članova skupštine.

**PRESEDAVAJUĆI SKUPŠTINE**  
**G. Rexhep Kurtbogaj**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

Komuna e Pejës



# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028

Shkurt, 2024



Funded by  
the European Union



**MNE-KOS**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO-KOSOVO 2014-2020

# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028

Implementuar nga:



Pejë, Shkurt 2024

## Përmbajtja

Fjala e kryetarit të komunës  
Falënderim  
Grupi punues për hartimin e PLVM-së  
Indeksi i shkurtesave  
Indeksi i tabelave

### **1. Hyrje**

- 1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVM-së
- 1.2. Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së
- 1.3. Procesi për përgatitjen e PLVM-së
- 1.4. Metodologjia për hartimin e PLVM-së

### **2. Profili i komunës**

- 2.1. Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ
- 2.2. Kushtet klimatike dhe relievi
- 2.3. Infrastruktura
- 2.4. Shëndetësia
- 2.5. Arsimi
- 2.6. Trashëgimia kulturore

### **3. Presionet në mjedis**

- 3.1. Popullsia dhe vendbanimet
- 3.2. Industria dhe Bizneset
- 3.3. Sektori minerar
- 3.4. Transporti
- 3.5. Bujqësia
- 3.6. Pylltaria
- 3.7. Turizmi

### **4. Gjendja e mjedisit**

- 4.1. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre
- 4.2. Ajri dhe zhurma
- 4.3. Menaxhimi i mbeturinave
- 4.4. Shfrytëzimi, ndotja dhe erozioni i tokave
- 4.5. Natyra dhe biodiversiteti
- 4.6. Shëndeti publik

### **5. Problemet kryesore mjedisore**

### **6. Prioritetet mjedisore për periudhën 2024-2028**

### **7. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2024-2028**

### **8. Plani i monitorimit për zbatimin e PLVM-së**

### **9. Referencat dhe burimet e informatave**

## Fjala e Kryetarit të Komunës

*Të nderuar qytetarë të komunës së Pejës, të nderuar lexues!*

*Kam kënaqësinë që po ndajmë me ju Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2028 për Komunën e Pejës, si dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal.*

*Ky plan ka për qëllim kryesor përmirësimin e gjendjes së mjedisit në territorin e komunës. Në kuadër të planit është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit, janë identifikuar problemet kryesore mjedisore, janë përcaktuar prioritetet kryesore si dhe janë planifikuar afatet, veprimet, aktivitetet dhe projektet kryesore që do të ndërmerren për periudhën e ardhshme 5 vjeçare për mjedisin e Pejës.*

*Hartimi dhe miratimi i këtij plani i cili është i një rëndësie të veçantë për komunën është kërkesë ligjore që del nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe po ashtu është pjesë e angazhimeve të komunës për përmbushjen e përgjegjësisë për fuqizimin e qeverisjes lokale.*

*Hartimi i planit është si rezultat i punës së grupit punues komunal dhe i ekspertëve nga projekti NERA të cilët gjatë punës së tyre kanë bashkëpunuar ngushtë me të gjitha drejtoritë e komunës, me institucionet tjera relevante të nivelit lokal dhe qendror dhe me specialistë të fushës nga komuniteti dhe organizatat e shoqërisë civile. Rezultat i këtij angazhimi është finalizimi i këtij dokument i cili pritet të ofrojë zgjidhje problemeve mjedisore dhe të përmbush objektivin për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm në komunën tonë.*

*Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal dhe me dokumente tjera strategjike dhe zhvillimore të komunës, dhe ka për objektiv kryesorë një mjedis të pastër në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës së Pejës.*

*Për implementimin e këtij plani komuna ka bërë edhe planifikimin e nevojshëm buxhetor por njëkohësisht ky dokument do të shërbejë edhe për të adresuar kërkesat për mbështetje nga donatorët për implementimin e projekteve konkrete të këtij plani.*

*Me këtë rast shpreh falënderimin për të gjithë ata që kontribuan në finalizimin e këtij dokumenti, e veçanërisht për programin e Bashkimit Evropian për bashkëpunimi ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 që ka ofruar mbështetje për hartimin e këtij plani.*

*Ju faleminderit,*

*Gazmend Muhaxheri, Kryetari i Komunës së Pejës*

## Falënderim

*Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028, është përgatitur nga grupi punues i komunës së Pejës, në bashkëpunim, me ekspertët nga projekti "NERA".*

*Plani është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "NERA" (New Environment Responsibility Approach) si pjesë e programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2014-2020.*

*Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Komunës së Pejës, dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të Bashkimit Evropian.*

*Komuna e Pejës shpreh falënderim për zyrën e programit të Bashkimi Evropian për bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2014-2020, për mbështetjen dhe kontributin e dhënë në hartimin e këtij plani.*

## Grupi punues për hartimin e PLVM-së

Përbërja e Grupit për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, është përcaktuar me vendimin nr. 112-02/99033/2023, për Formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit të Veprimit në Mjedis (PLVM) të datës 03.10.2023, të kryetarit të komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri.

Grupi punues ka këtë përbërje:

- Arta Vokshi-Nallbani, anëtare, drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Nasret Hajrizi, anëtar, drejtor i Zhvillimit Ekonomik;
- Nita Panduri, anëtare, drejtor për Administratë;
- Gani Kryeziu, anëtar, KRM Ambienti SHA Pejë;
- Agron Nikqi, anëtar, drejtor për Punë Komunale dhe Shërbime Teknike;
- Merita Kuraja, anëtare, udhëheqëse e sektorit për mbrojtje të mjedisit në DUMM;
- Miftar Shala, anëtar, inspektor i mjedisit në DI;
- Mentor Bajri, anëtar, anëtar, Asambleja Komunale e Kuvendit të Komunës;
- Naim Bytyqi, anëtar, Asambleja Komunale e Kuvendit të Komunës;
- Hajrije Haxhijaj, anëtare DBF;
- Ilir Lulaj, anëtar, Zyrtar për menaxhimin e mbeturinave në DPKSHT;
- Lulzim Shala, anëtar, përfaqësues i Bashkësive Lokale;
- Mimoza Hyseni-Spahi, anëtare, përfaqësuese nga Universiteti "Haxhi Zeka";
- Urim Xheravina, anëtar OJQ-Let's Do it Peja;
- Nora Draga, anëtare, Kuvendi i të Rinjve.

Grupi punues ka për detyrë dhe përgjegjësi që në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të hartojë draft planin e veprimit në mjedis për komunën e Pejës.

## **Indeksi i shkurtesave**

AMF	Ambulanca e Mjekësisë Familjare
AMMK	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ARRU	Autoriteti Rregullativ për Ujësjellës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DSHP	Drejtoria për Shërbime Publike
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit
GIZ	Organizata Gjermane për Shoqëri të Hapur
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë
KDSH	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjellësit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MFK	Milenium Foundation Kosova
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ME	Ministria e Ekonomisë
NERA	New Environment Responsibility Approach
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVB	Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendrat e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRTK	Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor



## **Indeksi i tabelave**

- Tabela 1:** Ligjet tjera, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre
- Tabela 2:** Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Pejës
- Tabela 3:** Numri i objekteve të trashëgimia kulturore të komunës së Pejës sipas kategorive
- Tabela 4:** Vlerësimi i popullsisë për komunën e Pejës 2021
- Tabela 5:** Të dhënat për numrin e bizneseve të komunës së Pejës sipas llojit të aktiviteteve
- Tabela 6:** Operatorët ekonomik në sektorin minerar në komunën e Pejës
- Tabela 7:** Vlerat mesatare vjetore të nivelit të ujit H (cm) prurjeve Q (m<sup>3</sup>/sec) sipas stacioneve matëse në vitin 2022 dhe trendi në raport me vitin 2021
- Tabela 8:** Karakteristikat e stacionit monitoruese për cilësinë e ajrit në Pejë
- Tabela 9:** Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011
- Tabela 10:** Cilësia e Ajrit në Pejë, 2022
- Tabela 11:** Cilësia e Ajrit në Pejë (përqendrimi vjetor mesatar sipas parametrave) 2019-2022
- Tabela 12:** Emetimet në ajër për territorin e komunës së Pejës [Mg/vit]
- Tabela 13:** Hot spotet në komunën e Pejës
- Tabela 14:** Erozioni sipas kategorive
- Tabela 15:** Treguesit e menaxhimit të mbeturinave në komunën e Pejës (2021)
- Tabela 16:** Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura
- Tabela 17:** Shkaqet e vdekjeve në komunën e Pejës (2018-2019)
- Tabela 18:** Problemet kryesore mjedisore
- Tabela 19:** Prioritetet mjedisore për periudhën 2024-2028
- Tabela 20:** Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2024-2028 dhe përgjegjësit për implementim
- Tabela 21:** Plani i monitorimit për zbatimin e PLVM, indikatorët e suksesit dhe ndikimi i pritshëm

## 1. Hyrje

### 1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVM-së

Plani Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) është dokument planifikues - strategjik, për të adresuar zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal. Hartimi dhe miratimi i tij është paraparë me Ligjin për Mjedis (2009/03-L-025). Neni 5, pika 3.2 e këtij ligji, ua përshkruan komunave përgjegjësinë, në bashkëpunim me MMPHI, për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre. Kurse, pika 3.5 udhëzon: “planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi komunal përkatës”.

Ndërkaq, në mënyrë më specifike, Neni 24 flet për “Planet e Veprimit Lokal në Mjedis dhe Programet Mjedisore” ku pika 1. Specifikon “Komunat miratojnë planet e veprimit lokal në mjedis ose programe mjedisore për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis sipas interesave specifike të saj”.

Gjatë hartimit të këtij Plani janë marrë për bazë edhe kërkesat e Strategjive Nacionale që adresojnë çështjet e mbrojtjes së mjedisit në Kosovë dhe të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, që paraqesin bazën për hartimin e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis, orientimet strategjike dhe kornizën e veprimeve për mbrojtjen e mjedisit në nivel nacional.

Në hartimin e dokumentit janë marrë në konsideratë edhe ligjet e fushës së mjedisit që prekin interesat në nivelin lokal. Një përshkrim i këtyre ligjeve është prezantuar në tabelën 1.

**Tabela 1: Ligjet tjera, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre<sup>1</sup>**

Ligji	Qëllimi dhe fushëveprimi
<b>Ligji nr.04/l-147 për ujërat e Kosovës</b>	Me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin, mbrojtjen dhe përgjegjësitë institucionale në lidhje me ujërat dhe burimet ujore, duke përfshirë edhe kompetencat e komunave për ujërat.
<b>Ligji nr. 03/l-233 mbi mbrojtjen e natyrës</b>	Me këtë ligj përcaktohet sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës (e tërë laramanisë biologjike dhe peisazhore) dhe vlerave të saj, duke përfshirë edhe kompetencat e komunave për mbrojtjen e natyrës.
<b>Ligji nr. 03/l-125 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja</b>	Ky ligj ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat

<sup>1</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/>)

	natyrore e kulturore të mjedisit. Po ashtu përcakton edhe kompetencat e komunave për menaxhimin e cilësisë së ajrit.
<b>Ligji nr. 02 / I-102 për mbrojtjen nga zhurma</b>	Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare të ndikimeve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit ndaj zhurmës.
<b>Ligji nr.03/I-153 për pyjet e Kosovës</b>	Ky ligj i definon pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.
<b>Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale</b>	Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.
<b>Ligji nr. 08/L-250 për ndryshime klimatike</b>	Ky ligji ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të autoriteteve shtetërore lidhur me marrjen e masave që synojnë zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike, koordinimin dhe monitorimin e rezultateve të tyre, si dhe përmbushjen e detyrimeve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të detyrueshme për Kosovën. Nga ky ligj dalin edhe obligime që duhet të përmbushen nga komunat, sikurse është hartimi i Planit Komunal për Energji dhe Klimë.

Në tabelën 2 janë prezantuar dokumentet planifikuese dhe strategjike të komunës së Pejës që janë marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të objektivave dhe aktiviteteve të PLVM.

**Tabela 2:** Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Pejës

<b>Dokumenti</b>	<b>Qëllimi dhe fushëveprimi</b>
<b>Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Pejës 2020-2028</b>	Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Pejës, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme

*Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028*

	dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.
<b>Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2009-2015, Komuna e Pejës</b>	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, është dokument planifikimi që rregullon menaxhimin e mjedisit në nivel lokal. Plani synon përmirësimin e gjendjes së mjedisit përmes masave dhe aktiviteteve. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për komunën e Pejës, ka përcaktuar masat dhe aktivitetet në territorin e komunës për periudhën 2009-2015.
<b>Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, Komuna e Pejës</b>	Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave është dokument planifikimi që rregullon Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal. Plani synon shtrirjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjithë territorin e komunës.
<b>Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027, Komuna e Pejës</b>	Plani Lokal i Veprimit për cilësi të ajrit 2023-2028, për Komunën e Pejës, është dokument planifikimi që rregullon menaxhimin e cilësisë së ajrit në territorin e komunës. Plani synon përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe reduktimin e ndotjes së ajrit përmes masave dhe aktiviteteve për një periudhë 5 vjecare.
<b>Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë 2018-2022 për Komunën e Pejës</b>	Objektivi i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në objektet publike, transport dhe ndriçim publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Pejës.
<b>DEMO për Mobilitetin Urban në Pejë</b>	Është një kronizë e planifikimit të qendrushëm të mobilitetit urban për komunën e Pejës, i realizuar në kuadër të projektit MOBKOS, planifikimin të qendrushëm të mobilitetit urban për Kosovë. Qëllimi i kësaj kornize është harmonizimi i nevojave për lëvizje për të gjithë pjesëmarrësit në trafik dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të transportit dhe lëvizjeve të tjera.
<b>Plani Regjional i Trashëgimisë 2012-2015 (Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë)</b>	Ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në territorin e Komunave Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë
<b>Plani Operativ Emergjent Lokal i Komunës së Pejës</b>	Plani Operativ Emergjent Lokal i Komunës së Pejës, ofron reagimin ndaj emergjencave dhe fatkeqësive me qëllim të shpëtimit të jetëve; mbrojtjes së shëndetit publik, sigurisë dhe të mirave materiale; restaurimin e shërbimeve esenciale; dhe për të mundësuar dhe asistuar në rimëkëmbjen ekonomike.
<b>Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2026 për komunën e Pejës</b>	Korniza Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale e cila siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton

	parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Po ashtu ky dokument, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.
<b>Statuti i Komunës së Pejës</b>	Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetanake të organeve komunale.

## 1.2. Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal për Veprim në Mjedis për komunën e Pejës është që të identifikoj problemet mjedisore, të përcaktojë prioritetet në sektorin e mjedisit dhe të ofrojë zgjidhje për problemet prioritare mjedisore, duke synuar një menaxhim më efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse.

Objektivat specifike të planit janë:

- Të bëjë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm zhvillimor;
- Të identifikoj dhe përcaktoj problemet kryesore mjedisore në territorin e komunës së Pejës;
- Të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVM-së për periudhën 5 vjeçare;
- Të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për adresimin e prioriteteve të identifikuar.

## 1.3. Procesi i hartimit të PLVM-së

Për hartimin e PLVM, Komuna e Pejës ka marrë mbështetje nga Bashkimi Evropian në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2014-2020.

Në kuadër të aktiviteteve për hartimin e këtij plani, fillimisht është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të projektit NERA dhe Komunës së Pejës, dhe ku ndër aktivitetet e projektit është paraparë edhe hartimi i PLVM.

Kryetari i komunës së Pejës Gazmend Muhaxheri, me datë 03.10.2023 ka miratuar vendim për caktimin e Grupit për hartimin e PLVM, me qëllim që të koordinojë aktivitetet për hartimin dhe miratimin e tij.

Si pjesë e aktiviteteve për hartimin e PLVM, Grupi Punues nga Komuna e Pejës ka mbajtur disa takime koordinuese me Grupin Punues të Komunës së Tuzit si bashkëpartner të

projektit. Takimi i parë koordinues është mbajtur me datën 19.10.2023, ndërsa që me datën 15.12.2023, Grupi Punues i PLVM nga Peja, ka marrë pjesë edhe në dëgjimin publik për PLVM të komunës së Tuzit.

Gjatë periudhës kohore tetor-dhjetor 2023, janë mbledhur informatat dhe të dhënat e nevojshme për hartimin e PLVM për Komunë e Pejës dhe është përgatitur drafti fillestar i dokumentit.

Me datën 31.01.2024 është mbajtur punëtorja për PLVM të Komunës së Pejës ku është prezantuar gjendja e mjedisit janë identifikuar problemet kryesore mjedisore dhe janë përcaktuar objektivat, prioritetet dhe veprimet për PLVM. Pjesë e punëtorisë përveç Grupit Punues nga Komuna e Pejës ka qenë edhe Grupi Punues i Komunës së Tuzit. Diskutimet dhe puna në grupe e realizuar gjatë punëtorisë kanë shërbyer për përgatitjen e draftit final të dokumentit të PLVM që do të shërbejë për konsultim publik.

#### **1.4. Metodologjia e hartimit të PLVM-së**

Metodologjia e hartimit të PLVM dhe përcaktimit të prioriteteve të tij është orientuar duke u bazuar në proceset si vijon:

- **Identifikimin e presioneve kryesore** në mjedisin e komunës së Pejës, që vijnë nga sektorët e ndryshëm zhvillimorë bazuar në të dhënat ekzistuese dhe trendet e tyre.
- **Analizën e gjendjes ekszituese** të mjedisit në Komunën e Pejës ku është bërë prezantimi i gjendjes aktuale mjedisore bazuar në të dhënat në dispozicion. Në kuadër të analizës së gjendjes është prezantuar gjendja e sektorëve zhvillimorë të komunës dhe gjendja e mjedisit në komunë. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore që ka komuna dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm.
- **Identifikimi i problemeve kryesore mjedisore** të cilat do të trajtohen për zgjidhje në kuadër të PLVM duke marrë për bazë kapacitetet financiare dhe zhvillimore të komunës dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre.
- Duke u bazuar në këto probleme mjedisore janë **përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën 5 vjeçare** dhe janë grupuar ato sipas tematikave përkatëse mjedisore.
- Bazuar në prioritetet kryesore mjedisore është propozuar edhe **plani i veprimeve për përmbushjen e këtyre prioriteteve**, që do të shërbejnë komunës për të hartuar projektet konkrete të mbështetura nga buxheti i komunës apo nga sigurimi i fondeve nga donatorët.
- Për të siguruar një implementim më efikas të PLVM është propozuar **Plani i monitoimit për zbatimin** e tij, ku janë përcaktuar edhe treguesit përkatës të monitoimit sipas prioriteteve.

## 2. Profili i Komunës

### 2.1. Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ

Komuna e Pejës shtrihet në Kosovën perëndimore në majen veriperëndimore të rrafshit të Dukagjinit (figura 1) në gjërësi gjeografike 42.6593° N dhe gjatësi gjeografike 20.2887°. Në perëndim dhe në veri kufizohet me Bjeshkët e Nemuna. Në veri-perëndim Komuna kufizohet nga Mali i ZI përmes komunave të Plavës, Beranit dhe Rozhajës. Vendkalimi kufitar ndodhet në Kullë 30 km larg Pejës. Në veri-lindje, Komuna kufizohet me komunën e Istogut, në lindje me komunën e Klinës dhe në jug nga komuna e Gjakovës dhe Deçanit.

Në pikën e saj më të ulët ka lartësi mbidetare prej 505 metrash, ndërsa në pikën e saj më të lartë (Guri i Kuq), ka lartësi mbidetare prej 2,522 metra.

Qyteti i Pejës gjendet nja 80 km larg kryeqytetit, Prishtinës. Komuna ka sipërfaqe prej 603 km<sup>2</sup>. Qyteti shtrihet në rrafshin aluvial të Lumëbardhit të Pejës, në hyrje të grykës së Rugovës, një zonë malore bjeshkët e së cilës formojnë një kurorë majash të larta si: Kopraniku (2460 m), Zhlebi (2352 m), Hajla (2460 m), Mokra (1932 m), Guri i Kuq (2522 m), etj.

Hekurudha dhe rruga kombëtare sigurojnë lidhje të mirë me kryeqytetin e Prishtinës dhe e lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe të mallrave në mbarë vendin.

Komuna e Pejës i ka më shumë se 25,700 hektarë pyje që mbulojnë nja 43% të sipërfaqes së komunës dhe 31,250 hektarë tokë bujqësore (52%).

Qyteti i Pejës paraqet qendrën administrative, ekonomike e kulturore për gjithë territorin e komunës, por edhe për komunat fqinje, si qyteti më i madh i rajonit perëndimor.



**Figura 1:** Vendndodhja e komunës dhe rajonit të Pejës në Kosovë

Trendi i zhvillimeve nga viti 1970 deri në vitin 1980 dëshmon që e gjithë komuna e Pejës është zhvilluar në mënyrë të njëtrajtshme. Koncentrimi i zhvillimeve ka qenë më i madh në qytetin e Pejës, ndërsa më i shpërqendruar dhe i pa balancuar në zonat rurale. Në 20 vitet e fundit vërehet trendi i shtuar i migrimit të brendshëm nga i cili presioni më i madh është orientuar në zonën urbane të komunës. Pasojë e këtij zhvillimi të pa balancuar në mes të zonës rurale dhe urbane, është humbja relativisht e madhe e tokës bujqësore në komunë.

Qyteti i Pejës i takon tipit të grumbulluar të dendur të vendbanimeve, me sipërfaqe të ndërtuar prej 1.207ha apo 74% nga e gjithë sipërfaqja e zonës urbane. Nëse e analizojmë madhësinë e parcelave në zonën urbane, atëherë del se kemi të bëjmë më një territor mjaft të fragmentuar ku shumica e parcelave, nuk janë më të mëdha se 3 ari. Raporti në mes të zonës së ndërtuar dhe asaj të lirë është 7.9% me 92.1 % në favor të zonës së pa ndërtuar.



## 2.2. Kushtet Klimatike dhe Relievi

Klima e komunës së Pejës është e mesme - kontinentale me ndikim të asaj mesdhetare që depërton nëpër luginën e Drinit të Bardhë. Kjo klimë është e ndikuar nga pozita gjeografike, lartësia mbi detare dhe kushtet meteorologjike.

Temperatura mesatare shumëvjeçare vjetore është 11.6°C. Temperatura mesatare shumëvjeçare e korrikut është 21.7°C , ndërsa e janarit - 0,5°C. Temperatura më e ulët e regjistruar është -23°C në dhjetor, dhe më e larta 35°C në gusht.

Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë ndër më të mëdhatë në Kosovë. Mesatarja vjetore shumëvjeçare e të reshurave në pjesën kodrinore-fushore është rreth 800 mm, e në pjesën bregoremalore arrin mbi 1.025 mm.

Erërat janë me shpejtësi të mesme 1.3 m/s, më të shpeshtat ato jug-perëndimore dhe perëndimore.

Lagështia mesatare e ajrit gjatë vitit është 70,2%. Lagështia më e madhe mesatare e ajrit është në dhjetor, kurse më e vogla në qershor.

Dielloshja është e mirë, me një numër të mjaftueshëm ditësh me diell. Numri mesatar i ditëve të vrenjtura (75.9) dhe të këthjellta (155 ditë) gjatë vitit është i volitshëm, me 1958 orë në vit.

Territori i Komunës së Pejës shquhet nga një reliev i çrregullt dhe i larmishëm, në të cilin dallohen disa tërësi hapësinore me veçori karakteristike:

- Bjeshkët e Rugovës, zonë malore që shtrihet në pjesën perëndimore të komunës, pjesë e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”;
- Burimet Veriore - zonë kodrinore në veri të qytetit, e pasur me ujëra e vegjetacion;
- Trekëndëshi - zona me karakter bujqësor në veri lindje e kufizuar nga dy rrugët rajonale;
- Zona bujqësore- rrafshi aluvial i Lumbardhit të Pejës në lindje;
- Zona urbane - qyteti i Pejës, i vendosur në mes të këtyre tërësive, me pozitë qendrore në komunë.

### 2.3. Infrastruktura

Sipas të dhëneve nga PZHK rreth 86.1 % kanë qasje në ujësjellës ndërsa pjesa tjetër e banorëve 13.9 % janë pa ujësjellës. Sistemi i kanalizimit, mbulon vetëm 73.42 % të vendbanimeve duke përfshirë 71.26% të ekonomive familjare. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë prej 96.450 banorë sa ka Komuna e Pejës, 66.7% kanë qasje në sistemin e kanalizimit, 15.5% e banorëve kanë pjesërisht qasje dhe pjesa tjetër prej 17.8% e popullsisë së komunës nuk kanë fare qasje në këtë rrjet.

Sistemi i ujitjes realizon ujitjen në 30% të sipërfaqes së tokës bujqësore të komunës, me anë të kanaleve të hapura që nënkupton ujitje me përmbytje. Kjo përfaqëson mënyrën më ekstensive të ujitjes që karakterizohet me shpenzime maksimale të ujit. Ndryshimi i kësaj forme të ujitjes në atë me kanal të tipit të mbuluar apo spërkatje kërkon mjete financiare, por do të ndikonte shumë në avancimin e prodhimit të bujqësore;

Sa i përket energjisë në komunë, një nga problemet kryesore është gjendja e vjetruar e rrjetit elektrik. Shumica e objekteve të banimit furnizohen me energji nga kabllot mbitokësore, të cilat në të shumtën e rasteve janë në gjendje jo të mirë. Rinovimi i këtij sistemi të vjetruar është i domosdoshëm dhe duhet të ketë prioritet të lartë. Në kuadër të përpjekjeve për ndryshimin e gjendjes në sektorin e furnizimit me energji elektrike, duhet të shfrytëzohen potencialet ekzistuese për zhvillimin e energjisë alternative. Para së gjithash, duhet të shqyrtohen mundësitë e shfrytëzimit të burimeve alternative të energjisë nga dielli dhe era.

Transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e komunës së Pejës bëhet përmes transportit rrugor dhe më pak atij hekurudhor. Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale (M9, R-106, R-107, R-101) në gjatësi prej 103km, dhe rrugët lokale në gjatësi prej 780km, i mundësojnë komunës lidhje të mira me shtetet fqinje dhe komunat tjera në Kosovë. Vija hekurudhore në relacionin F. Kosovë - Pejë është e gjatë 81,2 km.

### 2.4. Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore në komunën së Pejës ofrohen nëpërmjet rrjetit të institucioneve shëndetësore të organizuara në dy nivele: Kujdesi parësor shëndetësor (QKMF, QMF dhe AMF) dhe Kujdesi dytësor shëndetësor (spitali regional).

Rrjeti publik i KPSH përbëhet nga gjithsej 23 institucione, nga të cilat Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi kryesore, dhe njësitë e saj përbërëse: 7 Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 12 Ambulancat Mjekësisë Familjare (AMF), 1 Poliklinikë e stomatologjisë, Qendra kryesore e vaksinimit dhe Njësia e Urgjencës në objekt të veçantë. Në kuadër të QKMF-së funksionon edhe Qendra Informuese për Shëndetin e Gruas “Klasat për Nëna”.

Kujdesi dytësor shëndetësor (KDSH) ofrohet në Spitalin e Përgjithshëm, i cili mbulon me shërbime edhe banorët e Komunave Istog, Klinë, Deçan e Junik. Shërbimi është i organizuar në 5 departamente me 27 reparte dhe njësi në të cilat punojnë specialistë pothuajse në të gjitha degët e mjekësisë. Spitali ka kapacitet prej 389 shtretër, dhe ka gjithsej 513 të punësuar: 113 mjekë, 331 infermierë dhe 60 bashkëpunëtorë shëndetësor dhe të tjerë.

## **2.5. Arsimi**

Arsimi në komunën e Pejës është i organizuar në nivel të arsimit parauniversitar: duke filluar nga niveli parashkollor/parafillor, pastaj arsimin e obliguar fillor, të mesëm të ulët, mesëm të lartë dhe atij universitar dhe zhvillohet në institucionet përkatëse publike, universiteti "Haxhi Zeka" dhe private kolegji "UBT".

Bazuar në të dhënat e ASK-së, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021-2022, nxënësit në arsimin publik, niveli parauniversitar, numri i fëmijëve pjesëmarrës në komunën e Pejës ka qenë 16,872 fëmijë prej të cilëve 8,635 meshkuj dhe 8,237 femra.

Në nivelin universitar, universitet publik "Haxhi Zeka", niveli bachelor 6,825 student vendas , prej të cilëve 2,582 femra dhe 4,243 meshkuj si dhe 146 student nga jashtë vendit, gjithsejtë 6,971 student. Numri i stafit profesional, administrative dhe ndihmës është 1,532 persona.

Në arsimin privat, niveli parauniversitar, numri i fëmijëve pjesëmarrës në komunën e Pejës ka qenë 1,001 fëmijë prej të cilëve 520 meshkuj dhe 481 femra. Numri i objekte shkollore në komunën e Pejës është gjithsejtë 46 objekte, ndërsa numri i çerdheve 2 (funktionale) dhe 2 pritet të vihen në funksion së shpejti.

## **2.6. Trashëgimia Kulturore**

Rrethanat historike në territorin e Pejës kanë lënë një trashëgimi të pasur kulturore me vlera materiale dhe shpirtërore. Përmes saj mund të përcillet vazhdimësia e zhvillimit të kulturës dhe qytetërimeve të këtij rajoni, në të cilën të gjitha brezat lanë gjurmët e tyre të dallueshme, që nga mijëvjeçari i shtatë para Krishtit, deri në fillim të shekullit XX.

Sipas ligjit Nr. 02/L-88, Trashëgimia Kulturore e përhershme dhe e përkohshme nga MKRS kategorizohet si: Trashëgimi arkitektural (Monument/ansambli); arkeologjike (monument/ansambël dhe lokalitet arkeologjik/rezervat); trashëgimi të luajtshme; dhe trashëgimi shpirtërore. Tabela në vijim paraqet numrin e objekteve të trashëgimisë kulturore sipas kategorive, të cilat janë nën mbrojtje të MKRS-së.

**Tabela 3:** Numri i objekteve të trashëgimia kulturore të komunës së Pejës sipas kategorive<sup>2</sup>

Kategoria e objekteve	Nr.
Trashëgimia arkitekturale	88
Trashëgimia arkeologjike	22
Pejzazhet kulturore	2
Objektet e luajtshme	1
Zonat e veçanta të mbrojtura	1
Trashëgimia shpirtërore	1
<b>Gjithsej</b>	<b>115</b>

Si shihet edhe nga tabela, nga të gjitha kategoritë e trashëgimisë kulturore në Komunën e Pejës, ajo arkitekturale përfshin numrin më të madh të objekteve. Bazuar në informatat nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (QRTK) në Pejë, prej 88 objekteve të përfshira në listën e përkohshme, 63 prej tyre janë në gjendje të mirë, 19 në gjendje mesatare, 5 të dëmtuar dhe 1 fare nuk ekziston. Kjo na bën kuptojmë që pjesa dërmuese nga kjo listë nuk kërkon ndonjë intervenim serioz, ndërsa për pjesën tjetër duhet të ndërmerren masa konform ligjeve dhe praktikave të mirëfillta të konservimit.

Në monumentet me vlera arkitekturore dhe historike të cilat shtrihen në kohë që nga shek. XIV deri në gjysmën e dytë të shek. XX, pasqyrohet ndikimi i arkitekturës bizantine, sllave, otomane, por edhe asaj nga periudha e socializmit, duke zhvilluar kështu një trashëgimi kulturore specifike të Pejës. Objektet janë të karakterit të ndryshëm si: objekte kulti (kisha, xhami, varreza etj.), shtëpi të arkitekturës qytetare, shtëpi tradicionale Shqiptare – kulla, mullinj, etj.

<sup>2</sup> Lista e Trashëgimisë kulturore për mbrojtje të Përkohshme Nr.110/2018 dhe Lista e TK për mbrojtje të Përhershme Nr.69/2016

### 3. Presionet në mjedis

#### 3.1. Popullsia dhe vendbanimet

Sipas regjistrimit të Popullsisë së Kosovës në vitin 2011, numri i banorëve të komunës së Pejës është 96,450. Pak më shumë se gjysma e popullatës (48,962) jetojnë në zonën urbane, ndërsa 47 488 e popullsisë jetojnë në zonat rurale. Më shumë se gjysma e popullsisë, përkatësisht 48298 banorë janë femra, ndërsa 48152 janë meshkuj. Grup moshat dominante të popullsisë janë ato prej 10-19 vjet me 17785 banorë dhe ajo 0-9 vjet me 16028 banorë. Sipas vlerësimit të popullsisë për vitin 2021 të realizuar nga ASK numri i banorëve në komunë është 99073 (tabela 4).

**Tabela 4:** Vlerësimi i popullsisë për komunën e Pejës 2021<sup>3</sup>

Vlerësimi i popullsisë për komunën e Pejës	2021
Popullsia e vlerësuar	98601
Lindjet / Nataliteti	1293
Vdekjet / Mortaliteti	821
Shtimi natyror	472
<b>Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror</b>	<b>99073</b>

**Zona urbane** përkatësisht qyteti i Pejës si qendra më e madhe administrative e komunës ka sipërfaqe pre 25.2 km<sup>2</sup>. Qyteti i Pejës është i ndarë në 11 bashkësi territoriale me funksionet e tyre përcjellëse. Sipas organizimit administrativ në komunën e Pejës janë 71 vendbanime apo 90% e të gjitha vendbanimeve. Pothuajse 50 % nga totali, janë vendbanime me numër të vogël të banorëve, nën 500, dhe ndodhen në përgjithësi larg zonës urbane, në veçanti ato të cilat gjenden në zonën malore, të cilat pothuajse janë të braktisura.

#### 3.2. Industria dhe bizneset

Ekonomia lokale e komunës së Pejës përbëhet kryesisht nga tregtia, disa objekte industriale mesatare (të tullave, të përpunimit të drurit, të mobileve), ndërtimtaria dhe zeytaria. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në Komunën e Pejës janë të regjistruara 1747 biznese me rreth 15.000 të punësuar. Numri më i madh i këtyre bizneseve (642 sosh ose 36.7%) i takojnë tregtisë me shumicë dhe pakicë. 286 biznese ose rreth 16% i takojnë sektorit të industrisë përpunuese, 102 sektorit të ndërtimit dhe 208 atij të akomodimit dhe shërbimit të ushqimeve (tabela 5).

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (<https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/>)

Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara ( 71%) janë biznese individuale me 1-9 punëtorë, ndërsa, rreth 27% të bizneseve janë të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, dhe një numër më i vogël si ortakëri (2%).

**Tabela 5:** Të dhënat për numrin e bizneseve të komunës së Pejës sipas llojit të aktiviteteve<sup>4</sup>

Nr.	Bizneset sipas llojit të aktivitetit	Numri	%
1.	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	36	2
2.	Industria përpunuese	284	16.2
3.	Industria nxjerrëse	10	1
4.	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar,	1	0
5.	Furnizime me uje, kanalizime, mbeturina	5	0,3
6.	Ndërtimtari	102	6
7.	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike	642	36.7
8.	Transport dhe magazinim	49	3
9.	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	208	12
10.	Informacion dhe komunikim	32	2
11.	Financiare dhe sigurime, sigurim social, mbrojtje	13	1.2
12.	Patundshmëri	7	0.4
13.	Profesionale, shkencore dhe teknike	78	4
14.	Administrative dhe mbështetëse	41	2
15.	Arsim	32	2
16.	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	80	4
17.	Art, zbavitje dhe rekreacion	20	1
18.	Aktivitete tjera	107	6
	<b>Gjithsejt</b>	<b>1747</b>	

Marrë për bazë trendin e rritjes së sektorit të turizmit në vitet e fundit dhe orientimet zhvillimore të komunës për të ardhmen, në vitet në vijim mund të pritët një rritje në numrin e bizneseve që operojnë në sektorin e akomodimit dhe sektorit ushqimor.

Disa nga ndërmarrjet e mëdha shtetërore janë privatizuar pas luftës: Ish-fabrika e automjeteve tani është qendër tregtare (Elkos Group), ndërsa fabrika e drurit dhe lëkurës nuk funksionojnë më. Birraria e Pejës është punëdhënësi më i madh në Komunë.

Në Zonën Industriale të Pejës, operojnë disa nga kompanitë më të mëdha, jo vetëm brenda komunës së Pejës por edhe në nivel vendi. Prezenca e kompanive në pronësi të huaj vazhdon ende të jetë e ulët, si për nga numri i ndërmarrjeve po ashtu edhe për nga numri i të punësuarve.

Në aspekt të shpërndarjes hapësinore të ndërmarrjeve, mund të themi se bizneset e mëdha veprojnë në periferi të qytetit, në kuadër të zonës së planifikuar për zhvillim të industrisë, por edhe përgjatë rrugës Pejë - Prishtinë, deri në fshatin Zahaq.

<sup>4</sup> ASK 2022, Vjetari Statistikor 2021

Po ashtu ka zhvillime të depove dhe bizneseve prodhuese edhe në zona tjera si në Vitomicë, Brestovik, si dhe në Bellopojë, në zonën e rezervuar për zgjerim të banimit.

Në aspektin mjedisor, në komunën e Pejës nuk ka ndonjë industri që veprimtarinë e saj e ka të bazuar në djegje të burimeve fosile dhe që karakterizohet me emetime të larta në ajër.

### 3.3. Sektori minerar

Në territorin e Komunës së Pejës, veprojnë disa operatorë që kanë si veprimtari shfrytëzimin e gurit, rërës dhe zhavorrit dhe disa të tjera që kanë si veprimtari hulumtimin e rezervave të gurit, rërës dhe zhavorrit (tabela 6). Këto veprimtari krahas dëmtimit estetik të peisazhit dhe shtretërëve të lumenjëve karakterizohen edhe me emetime të pluhurit në ajër. Në veçanti operatorët e shfrytëzimit të gurit të fortë ndërtimorë gjatë procesit të thërmimit dhe bluarjes janë burim i emetimit të grimcave të pluhurit.

**Tabela 6:** Operatorët ekonomik në sektorin minerar në komunën e Pejës<sup>5</sup>

Operatorët sipas kategorive	Numri i operatorëve
Shfrytëzimi i gurit të fortë ndërtimorë	3 operatorë
Shfrytëzim i rërës dhe zhavorrit	17 operatorë
Hulumtim i rezervave të rërës dhe zhavorrit	12 operatorë

### 3.4. Transporti

Në komunën e Pejës modaliteti dominues i transportit është transporti rrugor, përmes së cilit bëhet transporti kryesor i njerëzve dhe i mallrave. Komuna e Pejës ka një rrjet të rrugëve që ofrojnë lidhje të mira me komunat tjera në Kosovë dhe shtetet fqinje. Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale që administrohen nga niveli qendror, është në gjatësi prej 103 km. Rrugët lokale janë në gjatësi prej 780 km dhe janë përgjegjësi e komunës. Vija hekurudhore në relacionin F. Kosovë - Pejë është e gjatë 81,2 km.

Në kuptim të trafikut, rruga nacionale M9 e cila e përshkon territorin e komunës në drejtimin lindje-perëndim, është rruga më e rëndësishme në komunë. Kjo rrugë nga kufiri lindor me Serbinë, kalon nëpër Prishtinë dhe Pejë, duke vazhduar nëpër Rugovë deri në kufirin perëndimor me Malin e Zi. Në drejtim të veriut, përmes rrugës R-106 (26.5 km), Peja lidhet me vendkalimin kufitar me Malin e Zi në Kullë. Me pjesën jugore të Kosovës, lidhet përmes rrugës rajonale R – 107 në drejtimin Pejë-Gjakovë-Prizren (70.3 km). Përmes rrugës rajonale R-101 (65.9 km) në drejtim të veri-lindjes lidhet me Mitrovicën.

<sup>5</sup> <http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>

Komuna e Pejës ka bërë një analizë të transportit/mobilitetit për zonën urbane, të hartuar nga projekti Mobkos. Studimi ka analizuar: rrjetin e rrugëve në raport me funksionet e pjesëve të ndryshme të qytetit, kapacitetin e udhëkryqeve të mëdha në qytet, lëvizjen e këmbësorëve, parkimin, dhe kategorizimin e rrugëve.

Bazuar në këtë metodologji, qyteti është ndarë në katër zona për analizë të sfidave dhe mundësive në planifikim të transportit të qëndrueshëm:

- Zona 1 – Qendra e Qytetit, Korzo;
- Zona 2 – Shërbimet Tregtare;
- Zona 3 - Banimi; dhe
- Zona 4 – Industria dhe Biznesi.

**Zona 1: Qendra e qytetit – Korzo** – Qendra e qytetit, për nga funksioni është zonë mikse: banim, administratë komunale dhe e nivelit qendror, institucione arsimore dhe shëndetësore (spitali rajonal, QKMF)), hoteleri, biznese të vogla, dhe hapësira publike (korzo – shëtitore, parqe). Dendësia relativisht e madhe e objekteve për banim, funksionet e kombinuara publike dhe private e kanë bërë të pamundur për komunën që të ofrojë-planifikojë infrastrukturë adekuate të transportit. Janë vetëm tri akset rrugore (rruga Mbretëresha Teutë, R107, dhe Gjeneral Wesley Clark) që shërbejnë si rrugë mbledhëse urbane, pra e bartin të gjithë ngarkesën e komunikacionit në zonë dhe ofrojnë qasje në të gjitha lagjet. Këto tri akse janë të vetmet që kanë profilin e duhur rrugor për të ofruar shërbim të transportit për zhvillimet hapësinore në zonë. Rrjeti i rrugëve tjera lokale është i çrregullt, me profile të ndryshme, në disa raste shumë të ngushta, gjë që e kufizon qasjen dhe vështirë qarkullimin. Problem tjetër i zonës është parkimi. Në këtë zonë janë në dispozicion 200 vendparkime publike përgjatë rrugës Mbretëresha Teutë, (të hotel Dukagjini) dhe tek objekti i QKMF-së.

**Zona 2: Shërbimet Tregtare** – Zona e dytë (lagjet Rrokaqielli dhe Haxhi Zeka), karakterizohet si hapësirë për banim (te ulët, të mesëm, dhe të lartë), me shumë shërbime tregtare, biznese të vogla, dhe më pak shërbime publike (policia, gjykata, prokuroria, institucione arsimore). Si e tillë është mjaft e frekuentuar nga qytetarët. Në këtë zonë gjendet edhe Çarshia e Gjatë, që është hapësirë e rezervuar vetëm për këmbësorë. Në krahasim me qendrën e qytetit, frekuentimi i këmbësorëve dhe veturave është më i ulët, përveç në akset kryesore (Mbretëresha Teutë, Bill Clinton, Adem Jashari dhe M9) që e bartin komunikacionin në drejtim të qendrës dhe jashtë qytetit. Në krahasim me qendrën, rrjeti i rrugëve edhe pse i parregullt, është pak më i qartë ndërsa dendësia e objekteve të banimit është pak më e ulët. Profili i rrugëve, edhe pse dallon nga ai i zonës së qendrës, as këtu nuk është adekuat dhe krijon probleme në komunikacion dhe parkim.

Problemet më të theksuara na paraqiten në lagjet me objekte shumë banesore (rruga Bill Clinton, Hysni Zajmi, etj). Përparësi e zonës është se pavarësisht nga profili i tyre i ngushtë,



rrugët shfrytëzohen për lëvizshmëri të përbashkët të automjeteve, biçikletave, dhe këmbësorëve, duke promovuar njëkohësisht tre modalitete të transportit. Sigurisht që kjo ka ardhë si pasojë e infrastrukturës jo-adekuate dhe kontrollit të dobët të zhvillimit.

**Zona 3: Banimi** – Zona e tretë (lagja Dardania), për dallim nga zonat tjera, si funksion dominues ka banimin (kryesisht banimin e ulët), të përcjellë me shërbime publike: institucione arsimore dhe ato për sport dhe rekreacion përveç shërbimeve të administratës që i ofron qendra e qytetit. Rrjeti i rrugëve në krahasim me të dy zonat tjera është i rregullt dhe me profil më të gjerë. Përveç në aksin kryesor Bekim Berisha që shërben si rrugë mbledhëse urbane, nuk ka tollovi në komunikacion. Rruga Bekim Berisha dhe R107 ngarkohen në rastet e ngjarjeve sportive në stadiumin Shahin Haxhislami, dhe hallën e sporteve. Parkimi nuk është problem i madh në krahasim me qendrën, mirëpo në vitet në vijim do të mund të krijohet si i tillë nëse zhvillimet e reja, sidomos objektet shumëbanesore, nuk respektojnë normat dhe standardet teknike për vend-parkime. Dardania nuk ka ndonjë hapësirë publike apo rrjet të vendosur për këmbësorë dhe biçikleta. Stadiumi i qytetit dhe fushat e tij përcjellëse, oborret e shkollave (shkolla Dardania) janë të vetmet hapësira publike që mund të shfrytëzohen nga qytetarët. Përparësi e zonës, është dendësia më e ulët e ndërtimit në krahasim me dy zonat tjera, si dhe qasja e lehtë me vetura.

**Zona 4: Biznesi dhe Industria** – Kjo zonë karakterizohet me funksione të banimit (të ulët, të mesëm, dhe të lartë), shërbime publike (institucione arsimore), industri të lehtë dhe biznese. Dendësia e ndërtimit në zonë është shumë më e ulët se pjesët e tjera të qytetit, kjo për faktin që afërsisht 40% e zonës nuk është e zhvilluar. Janë tre rrugë urbane mbledhëse (M9, R101, rruga e Birrarisë) dhe një rrugë urbane mbledhëse/lidhëse (rruga e transitit) të cilat e bartin komunikacionin në zonë dhe jashtë saj. Këtu parkimi nuk është problem duke marrë parasysh që hapësira është ende e pazhvilluar dhe udhëtimet janë relativisht të ulëta në zonë. Të vetmet zhvillime që gjenerojnë kërkesë për parkim, janë bizneset e mëdha që gjenden përgjatë pjesës jugore të rrugës Pejë – Prishtinë. Dendësia e ulët e ndërtimit, rrjeti më i rregullt i rrugëve me profil më të gjerë se në zonat tjera, ka ndikuar që zona të ketë qasje shumë më të mirë dhe komunikacion të rrjedhshëm. Në këtë aspekt, përparësia e zonës është që mund të ofrojë infrastrukturë të transportit për zhvillime të industrisë, biznesit, banimit të lartë, apo edhe banimit me standard më të lartë.

**Transporti hekurudhor**<sup>6</sup> - Infrastruktura hekurudhore është mjaft e vjetruar dhe në gjendje jo të mirë. Linja hekurudhore Fushë Kosovë-Pejë është një binarësh me një gjatësi 81.2 km, me shtypje boshtore 20.0 ton/bosht dhe shtypje gjatësore 6.4 ton/m.

---

*6 Plani Zhvillimor Komunal i Pejës 2020-2028, Komuna e Pejës 2019*

Përgjatë linjës ekzistojnë 6 tunele me gjatësi totale 2423 m, 8 ura të çelikut, 10 ura të betonit dhe 4 ura të gurit. Menaxhimi i infrastrukturës hekurudhore është përgjegjësi e kompanisë publike INFRAKOS, ndërsa operimet me trena menaxhohen nga TRAINKOS.

Në kushtet e tanishme, hekurudha ka një rol të vogël në transportin e udhëtarëve në komunë edhe pse ka interesim të shfrytëzohet. Ndërsa sa i përket transportit të mallrave, kërkesat janë të vogla. Linja nuk është e elektrifikuar dhe për shkak të kushteve teknike aktuale, shpejtësia maksimale e trenave është vetëm 50-60 km/h. Aktualisht, vija e rregullt për transport të brendshëm në relacionin Pejë-Prishtinë funksionon dy herë në ditë, në mëngjes dhe në mesditë.

Investimet në infrastrukturën e transportit kanë pasur në fokus lëvizjen e automjeteve, përderisa transporti i pamotorizuar nuk është adresuar në mënyrë sistematike si model i lëvizshmërisë në tërë komunën. Trotualet, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta janë adresuar deri në një masë, kryesisht bazuar në investimet primare në rrugë.

Transporti urban nuk është funksional, edhe pse komuna përmes partneritetit 50 publiko-privat ka bërë përpjekje për funksionalizimin e tij. Funksionalizimi i transportit publik do të reduktonte qarkullimin e veturave në zonën urbane të qytetit dhe to të ndikonte në uljen e ndotjes së ajrit.

Komuna e Pejës ka mundësi shumë të mira për zhvillim të një sistemi të qëndrueshëm të transportit, duke e promovuar transportin e pamotorizuar krahas atij për automjete dhe të mbështetur nga transporti urban.

Komuna e Pejës ka bërë një analizë të transportit/mobilitetit për zonën urbane, por nuk ka plan lokal të mobilitetit të aprovuar. Komuna duhet të hartojë dhe të miratojë një plan të tillë ku duhet të merren në konsideratë edhe masa për reduktimin e ndotjes së ajrit nga sektori i transportit.

### **3.5. Bujqësia**

Nga e gjithë sipërfaqja e territorit të komunës, 49% ose 27.538 ha është tokë bujqësore. Nga 7.141 ha tokë e punueshme, 4.095 ha ose 57 % e sipërfaqes kultivohen me drithëra, prej të cilëve më së shumti gruri me 1989 ha (49%) dhe misri me 1825 ha(45%), tërshëra me 224.98 ha dhe më pak thekra dhe elbi. Prodhimtaria në përgjithësi është e kënaqshme por nuk ka pasur rritje të dukshme të rendimentit ndër vite. Prodhimtarinë më të madhe e ka misri dhe gruri. Bimët foragjere përfshijnë 334.8 ha të tokës së punueshme ose 26.7% të sipërfaqes. Kryesisht kultivohet misri i gjelbër (32%), jonxha (30%), bari i përzier (19%) dhe tërfili (17%).

E shprehur për kokë banori: tokë bujqësore një banori i takojnë 0.27 ha. Më shumë se 50% e popullsisë së komunës jetojnë në zona rurale dhe bujqësia është veprimtaria prej së cilës ajo siguron ekzistencën e vet. Pjesa më e madhe e veprimtarisë bujqësore zhvillohet në mënyrë të paorganizuar, në ferma familjare me mekanizëm joadekuat dhe me mungesë të masave të nevojshme agro-teknike. Përdorimi jo i drejtë dhe inteziv i plehrave organike dhe kimike në bujqësi është burim i emetimeve në ajër.

Vështirësitë tjera me të cilat ballafaqohen fermerët janë ngastrat e fragmentuara dhe me sipërfaqe të vogël, teknologjia e vjetër, mungesa e kapitalit qarkullues, mungesa e marketingut, etj. Nga aspekti gjeografik, zhvillimi i bujqësisë shtrihet në pjesën e rrafshulëtës me bregore, në rrafshinat e Baranit, Logjës, Leshanit e Trestenikut, dhe në zonën e Vitomirices dhe Radacit.

Pjesa kodrinore malore prfshinë pyjet dhe kullosat alpine në zonën e Rugovës me 13 fshatrat e saj. Komuna e Pejës ka kushte mjaft të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë duke ju falënderuar llojllojshmërisë së bimëve mjaltëdhënëse dhe kohëzgjatjes së vegetacionit në rrafshin e Dukagjinit.

Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, perimet mbillen në rreth 425 ha ose 6% të tokës së punueshme në komunë, që është sipërfaqe mjaft e vogël duke pasur parasysh kushtet e volitshme agroekologjike dhe traditën bujqvë në kultivimin e tyre. Më së shumti kultivohen: speci (46%), qepa (11%), lakra (11%), domatja (10%) dhe shalqiri (5%), të cilat përfshijnë mbi 80% të sipërfaqeve të mbjella me perime. Gjithashtu kultivohen mjaft edhe patatet (144 ha) dhe fasulja (30 ha). Shumica e kulturave kanë rendimente më të larta në sipërfaqet e ujitura. Hapësira adekuate për kultivimin e perimeve ekzistojnë në rrafshinën e Baranit për kultivimin e specave, territori i Logjës dhe Raushiqit për kultivimin e domates, lakrës, dhe perimeve tjera, kurse rrafshina e Trestenikut për kultivimin e patates, specave dhe pemëve të imta - Dredhëzave etj.

Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, në Komunën e Pejës janë rreth 233 ha pemishte. Rreth 76% e kësaj sipërfaqe është e mbjellë me mollë, 13% me kumbulla, 4% me dardha, 2.5% me arra, etj. Hapësira adekuate për ngritjen e plantacioneve ekzistojnë në pjesën bregore që shtrihet nga fshati Zllapek në drejtim të fshatit Kryshec, Turjakë e tutje në drejtim të fushave të Ndërmarrjes shoqërore të Bujqësisë, për rreth fshatrave Qyshk dhe Bllagajë dhe në drejtim të trekëndëshit Vitomiricë, Dubovë, dhe Novosellë.

Sipërfaqet e konsiderueshme të kullosave dhe livadheve janë potencial i rëndësishëm i komunës së Pejës për zhvillimin e blegtorisë cila në veçanti shtrihet në pjesën e rrafshulëtës së Pejës dhe në pjesën kodrinore malore (Rugovë). Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2014, fondi blegtoral në ekonomitë bujqësore përbëhet nga 18199 gjedhë, 8599 dele, 1420 dhi, dhe 829 derra. Ndërsa numri i shpezëve ishte 90.317.

Promovimi i bujqësisë organike dhe përdorimi i qëndrueshëm i plehrave kimike dhe organike, do të ndihmonin edhe në reduktimin e emetimeve në ajër nga ky sektor.

### 3.6. Pylltaria

Pyjet mbulojnë rreth 45% të territorit të komunës apo 26.947 ha, ku rreth 32% e të cilave janë në pronësi private. Pjesa më e madhe e pyjeve shtrihet në zonën e Rugovës, në Bjeshkët e Nemuna dhe dominohet nga vegjetacioni pyjor gjetherënës si: pyjet e dushkut dhe ahut, dhe vegjetacioni halor si: pyjet e hormoqit, bredhit, rrobullit e arnenit. Si një prej komplekseve pyjore me cilësi më të lartë në vend, pasurisë së jashtëzakonshme të resurseve ujore, relikteve dhe specieve endemike të florës dhe faunës, bukurisë së natyrës dhe potencialit turistik, Bjeshkët e Nemuna janë shpallur Park Kombëtar në vitin 2012.

Sipas studimit të FAO-s, në vitin 2013 në Kosovë ishin 40 sharra zyrtarisht të licencuara, 17 prej tyre në komunën e Pejës, që vlerësohet se kanë përpunuar rreth 10550 m<sup>3</sup> dru/vit. Informatat nga tereni tregojnë për operimin e gjithsej 31 sharrave në komunë, që dëshmon për një numër të konsiderueshëm të operatorëve të palicencuar, ndërsa lënda e përpunuar vlerësohet rreth 20.000m<sup>3</sup> dru/vit.

Vlerësohet se më shumë se 70% e lëndës së parë drunore importohet. Ndërsa, tregu i prodhimit të lëndëve djegëse nga druri ka shënuar rritje dhe prodhuesi më i madh në Kosovë gjendet në Pejë dhe prodhon 14,000 ton /vit pelet dhe 400 ton/vit ashkla druri.

Konsumi i drurit për djegie është mjaft i lartë, mesatarisht rreth 8.99 m<sup>3</sup> dru/vit në amvisëritë rurale, dhe 7.43 m<sup>3</sup> dru/vit në amvisëritë urbane. Sipas vlerësimit të vitit 2014, bilanci lokal i ofertës/kërkesës në komunë është negativ, me një deficit prej -8.373 ton/vit. Përveç përdorimit të drurit si lëndë djegëse për ngrohje, edhe djegja e sipërfaqeve të pyjeve është një nga burimet e emetimeve në ajër.

Parandalimi i zjarreve në pyje, menaxhimi i qëndrueshëm i masës drunore dhe promovimi i sistemeve të ngrohjes qëndrore të bazuara në biomasë do të ndikojnë pozitivisht në reduktimin e ndotjes së ajrit në Komunën e Pejës.

### 3.7. Turizmi

Potencialet natyrore dhe të trashëgimisë kulturore me të cilat disponon komuna e Pejës ofrojnë mundësi konkurruese për zhvillimin e një oferte të larmishme turistike dhe tërheqjen e vizitorëve vendas dhe të huaj, e cila ende nuk është valorizuar në potencialin e saj të plotë. Duhet të theksohet se turizmi ka një efekt shumëfishues në ekonomi, sepse kontribuon në mënyrë indirekte në krijimin e të ardhurave të përgjithshme të komunës përmes zhvillimit të sektorëve tjerë si tregtia, bujqësia, transporti dhe ndërtimi. Edhe pse Peja është e pozicionuar lartë si destinacion turistik në Kosovë, numri i vizitorëve jashtë sezonit veror si dhe mesatarja e net-qëndrimeve është ende e ulët.

Territori i Komunës së Pejës është një destinacion turistik që ka shtrirje në tri nivele. Në nivelin lokal ka zhvilluar shtegun kulturor që prek 14 pika të trashëgimisë, pastaj shtigjet rekreative ditore për ecje në natyre dhe shtigje malore në Bjeshkët e Rugovës, 4 via ferrata ku secila është unike dhe kanë gjatësi të ndryshme, 7 zona të ngjitjes me 70 vija të ngjitjes, shpellat “Bukuroshja e Fjetur” si dhe “Gryka e Madhe” të cilat janë atraksione gjigante, Zip Line, fluturim me paraglide dhe trajke mbi Pejë, kayak, biçiklizëm rekreative në zonat e rrafshit të Pejës si dhe ato zonat malore etj.

Në nivelin Rajonal janë zhvilluar shtigjet e ecjes dhe biçiklizmit malorë që lidhin 3 komunat (Pejë, Deçan dhe Junik) ku kalon parku nacional Bjeshkët e Nemuna, ndërsa në zonat fushore është zhvilluar oferta e biçiklizmit rekreativ që lidhin 6 komunat rrafshit të Dukagjinit.

Në nivelin ndërkuftarë janë zhvilluar shtigjet e ecjes që lidhin shtetin e Kosovës me atë të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Është shtegu Majat e Ballkanit me gjatësi prej 192km që kalon ne territorin e bjeshkëve të Nemuna në tri shtetet. Gjithashtu janë zhvilluar 300km shtigje të ecjes dhe biçiklizmit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi përmes projektit Accursed Mountains – Exquisite Outdoor Destination<sup>7</sup>.

Në pjesën e Informimit dhe promovimit të turizmit Peja ka zhvilluar hapa të rëndësishme. Në këtë drejtim ka hapur dy zyre informative. Slogani i Pejës tani është “Peja destinacoin i gjelbër dhe vital “Duke u bazuar në këtë slogan Peja është duke punuar gjithnjë në mbrojtje të ambientit e për këtë është vlerësuar nga Green Belt si komuna shembull për mbrojtje të ambientit.

---

<sup>7</sup>[www.accursed-mountains.org](http://www.accursed-mountains.org)

## 4. Gjendja e Mjedisit

### 4.1. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre

Komuna e Pejës është një ndër komunat më të pasura me resurse ujore në Kosovë. Lumenjtë më të rëndësishëm janë Lumbardhi, Drini i Bardhë dhe Sushica. Për shkak të gjeomorfologjisë së saj Peja është e pasur edhe me ujëra nëntokësore. Këta lumenj së bashku me disa degë të tyre krijojnë pellgun lumor të Drinit të Bardhë. Ky pellg ka sipërfaqe më të madhe se sa pellgjet e lumenjve të tjerë të vendit tonë. Në komunën e Pejës shkallën e ndotjes së ujërave sipërfaqësore përveç shkarkimit të ujërave të zeza e rrisin edhe më shumë hedhja e mbeturinave, shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit. Po ashtu, ndotja vjen edhe nga ujërat që bëjnë shpëlarjen e tokave bujqësore dhe përdorimi joadekuat i kemikateve në bujqësi. Ndërsa ndotja e ujërave nëntokësore kryesisht vjen nga deponitë e shumta ilegale.

Gjatë vitit 2021 është lëshuar në fuksion impianti për trajtimin e ujërave të zeza urbane që trajton ujërat e zonës urbane të qytetit të Pejës dhe vendbanimit Qyshk. (shto te dhena per impiantin).

**Cilësia e ujërave sipërfaqësore-** Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Në kuadër të rrjetit të monitorimit janë edhe disa stacione në territorin e Komunës së Pejës përkatësisht në lumin Drini i Bardhë. Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizik (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Në raportin për gjendjen e mjedisit për vitin 2022 është prezantuar gjendja e ujërave përmes treguesve (parametrave): Oksigjeni i tretur ( $\text{mg/l O}_2$ ), shpenzimi biokimik i oksigjenit-  $\text{SHBO}_5$  ( $\text{mg/l O}_2$ ), shpenzimi kimik i oksigjenit-  $\text{SHKO}$  ( $\text{mg/l O}_2$ ), Karboni organik total-C ( $\text{mg/l}$ ); Fosfori total – P ( $\text{mg/l}$ ), materiet totale të suspenduara-MTS ( $\text{mg/L}$ ). Parametrat si: oksigjeni i tretur ( $\text{O}_2$ ), oksigjeni biokimik i shpenzuar për 5 ditë ( $\text{SHBO}_5$ ), shpenzimi kimik i oksigjenit ( $\text{SHKO}$ ), tregojnë nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujit i cili hynë në grupin e parametrave të cilët pritet të kenë ndikim nga ato dukuri që u cekën më lartë, derisa prezenca e fosforit ( $\text{P}_{\text{tot}}$ ) shkakton eutrofikimin në ujëra.

Në kuadër të rezultateve për Pellgu i Drinit të Bardhë, janë edhe 4 pika monitoruese në lumi Drini i Bardhë dhe në Lumbaridhin e Pejës përkatësisht stacionet Radavc, Drelaj, dalje të Pejës dhe në Grabanicë. Në stacionet Radavc dhe Drelaj nuk vërhehn ndikime në cilësinë e ujërave, ndërsa në stacionet në Dalje të Pejës dhe në Grabanicë vërhet një rritje e koncentrimin të nitriteve dhe fosfatave, që vije si rezultat i shakrimit të ujërave urbane dhe industriale.

**Sasia e ujërave** - Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga disa stacione matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Në këto stacione matet Niveli (H) dhe Prurja (Q). Në tabelën 7 janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (cm) dhe prurja (Q) në stacionet hidrometrike të regjionit të Pejës të realizuara për vitin 2022.

**Tabela 7.** Vlerat mesatare vjetore të nivelit të ujit H (cm) prurjeve Q (m<sup>3</sup>/sec) sipas stacioneve matëse në vitin 2022 dhe trendi në raport me vitin 2021

Stacioni matës	Mes. (cm) 2021	Mes. (cm) 2022
Grykë e Rugovës	76	72
Drelaj	60	67
Statcioni	Mes.( m3/sec) 2021	Mes.(m3/sec) 2022
Grykë e Rugovës	4.842	4.221

**Cilësia e ujit të pijes** i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, dhe Udhëzimin Administrativ Nr.15/2017, janë aktet nënligjore që rregullojnë mbrojtjen e ujërave të pijshëm. Sa i përket përgjegjësiwe institucionale Kompanitë Regjionale të Ujësjesit (KRU) kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor për konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Ndërsa Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik (IKSHPK), është institucion përgjegjës për kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm në tërë territorin e vendit. IKSHPK ka obligim që të sigurojë që uji i distribuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendore për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik.

Komuna e Pejës, ndodhet në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini. Sipas Raportit të performancës së KRU-ve për vitin 2022 të përgaditur ARRU, cilësia e ujit të pijes për zonën e KRU Hidrodrini, sa i përket parametrave mikrobiologjik ka përputhshmëri me standardet 99.4%, ndërkaq përputhshmëria me parametrat kimik është 87.1%<sup>8</sup>.

Me gjithë investimet e bëra nga ana e donatorëve të ndryshëm dhe institucioneve qendrore si dhe të vet kuvendit komunal, nevojat për investime në fushën e ujerave janë të mëdha. Duhet të investohet dhe t'iu sigurohet qytetarëve shërbime elementare të furnizimit me ujë të pijshëm, dhe sisteme të kanalizimit edhe për shumë vendbanime të kësaj komune. Për sa i përket rrjetit të ujësjesit janë të domosdoshme nevojat për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues dhe ndërtimin e rrjeteve të reja të ujësjesve. Ndërkaq, në sistemin e kanalizimeve të ujërave te zeza nevojat janë të mëdha pasi që, parashihet që në të gjitha fshatrat e komunës të ndërtohen rrjetat e kanalizimit dhe aty ku ka nevojë, të bëhet trajtimi i tyre.

<sup>8</sup> Raporti i Performancës së KRU-2022, ARRU.

Në komunën e Pejës, është me rëndësi të trajtohen ujërat që shkaktojnë përmytje, e që vinë si rezultat i përrenjve në zonat malore gjatë motit të lig me shira intensive bëhen shumë rrëmbyeshëm dhe të bartin material që e gjejnë në rrugën e tyre dhe kanë fuqi të madhe.

Komuna është kompetente edhe për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore, brenda zonave urbane është komuna.

## 4.2. Ajri dhe zhurma

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore. Ndotja e ajrit ndodh kur ajri përmban substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale.

Për cilësinë e ajrit në Komunë e Pejës mund të thuhet se ende është në nivel jo të kënaqshëm. Lidhur me cilësinë e ajrit mundë ti referohemi të dhënave nga stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit i tipit urban i vendosur në zonën urbane të qytetit që menaxhohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Të dhënat flasin se ka tejkalime të parametrave të lejuar sidomos gjatë stinës së dimrit.

**Tabela 8:** Karakteristikat e stacionit monitoruese për cilësinë e ajrit në Pejë<sup>9</sup>

Emërtimi i Stacionit monitorues	Shenja (Kodi) i stacionit	Parametrat e monitoruar	Tipi i zonës së monitorimit (sfondi)	Data e funksionalizimit
Pejë	KS0305	PM10, PM2.5, SO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> , CO, Ozoni	Sfondi urban	04.04.2012

**Tabela 9:** Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011<sup>10</sup>

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare) µg/m <sup>3</sup>	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO <sub>2</sub>	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e	µg/m <sup>3</sup>	30	Nuk parashihet

<sup>9</sup> Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2021, AMMK 2022

<sup>10</sup> Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2021, AMMK 2022



*Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028*

	vegjetacionit			
SO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore të maksimale 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m <sup>3</sup>	10	Nuk parashihet
PM10	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	120	Nuk parashihet

Qytetarët e Pejës, mundë të informohen për cilësinë e ajrit në këtë komunë edhe platformës online airquality që mundëson që të dhënat për cilësinë e ajrit të shikohen në kohë reale përmes ueb aplikacionit dhe përmes aplikacioneve në telefonat smart. Ky sistem është lansuar në fillim të viti 2018 dhe menaxhohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

Përmes sistemit online mundësohet informimi i saktë dhe në kohë reale i publikut për cilësinë e ajrit. Softueri për raportimin e të dhënave për cilësinë e ajrit është kompatibil me Indeks të Kualitetit të Ajrit në Evropë dhe prezanton të dhënat e monitorimit të 5 indikatorëve kryesor në 12 stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Në sistemin e të dhënave për cilësi të ajrit në kohë reale mundësohet qasje duke klikuar direkt në linkun e sistemit të të dhënave në ueb faqen e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, ueb apo edhe përmes linkut: <http://www.kosovo-airquality.com/secure/index2.html>.

Sipas të dhënave nga stacioni për monitrimin e cilësisë së ajrit në Pejë, gjatë vitit 2022 në Pejë janë regjistruar 29 tejkalime për parametrin PM10, dhe 11 tejkalime për parametrin O3, kurse gjatë vitit 2023, janë regjistruar 12 tejkalime për parametrin 10, dhe 7 tejkalime për parametrin O3. Përqëndrimet mesatare vjetore për parametrat e monitoruara kanë qenë brenda normave të lejuara (tabela 10).

Krahasuar me vitin 2021, ka rënie të tejkalimeve kur ishin regjistruar 49 tejkalime për parametrin PM10, dhe 9 tejkalime për parametrin O3.

**Tabela 10:** Cilësia e Ajrit në Pejë, 2022<sup>11</sup>

Parametri	Përqëndrimi vjetor mesatar	Tejkalimet 24 h	Tejkalimet 8 h	Tejkalimet 1 h
PM10	29.6 µg/m <sup>3</sup>	29		
PM2.5	21.5 µg/m <sup>3</sup>			
NO <sub>2</sub>	17.9 µg/m <sup>3</sup>			0
SO <sub>2</sub>	3.9 µg/m <sup>3</sup>	0		0
O <sub>3</sub>	60.6 µg/m <sup>3</sup>		11	
CO	0.7 mg/m <sup>3</sup>		0	

**Trendi i cilësisë së ajrit në Pejë 2019-2022** - Krahasuar me vitet 2019, 2020 dhe 2021, në vitin 2022 trendi i cilësisë së ajrit shënon një përmirësim të ndjeshëm sa i përket koncentrimin maestar vjetor të ndotësve. Nga rezultatet e prezantuara në tabelë vërehet se edhe përqëndrimet mesatare vjetore për shumicën e parametrave të monitoruar gjatë vitit 2022, kanë qënë me të ulëta se sa gjatë viteve 2019-2021.

**Tabela 11:** Cilësia e Ajrit në Pejë (përqëndrimi vjetor mesatar sipas parametrave) 2019-2022<sup>12</sup>

Parametri	2022	2021	2020	2019
PM10	23.6 µg/m <sup>3</sup>	29.6 µg/m <sup>3</sup>	36.4 µg/m <sup>3</sup>	30.2 µg/m <sup>3</sup>
PM2.5	17.3 µg/m <sup>3</sup>	21.5 µg/m <sup>3</sup>	28.7 µg/m <sup>3</sup>	27.5 µg/m <sup>3</sup>
NO <sub>2</sub>	15.4 µg/m <sup>3</sup>	17.9 µg/m <sup>3</sup>	14.3 µg/m <sup>3</sup>	13.9 µg/m <sup>3</sup>
SO <sub>2</sub>	9.4 µg/m <sup>3</sup>	3.9 µg/m <sup>3</sup>	10.2 µg/m <sup>3</sup>	0.6 µg/m <sup>3</sup>
O <sub>3</sub>	58.0 µg/m <sup>3</sup>	60.6 µg/m <sup>3</sup>	35.9 µg/m <sup>3</sup>	17.0 µg/m <sup>3</sup>
CO	0.6 mg/m <sup>3</sup>	0.7 mg/m <sup>3</sup>	0.6 mg/m <sup>3</sup>	0.8 mg/m <sup>3</sup>

**Emisionet në ajër** - Bazuar në studimin e realizuar në kuadër të projektit gjatë vitit 2021, është bërë edhe inventarizimi i burimeve të emetimeve në ajër për territorin e Komunës së Pejës. Burimi kryesor i emetimeve të grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2.5 janë djegjet e vogla dhe transporti. Djegjet e vogla janë burimi kryesor i emetimit edhe për CO. Burimi kryesor i emetimit të NO<sub>x</sub>, është transporti rrugor, industria dhe bujqësia, ndërsa burimi kryesor i SO<sub>2</sub> është Industria. Sa i përket ndotësit NMVOC, burimi kryesor i emetimit janë djegjet e vogla, pyjet dhe bujqësia (tabela 12).

<sup>11</sup> Air Quality in Kosovo [Air Quality Portal \(rks.gov.net\)](https://rks.gov.net)

<sup>12</sup> Air Quality in Kosovo [Air Quality Portal \(rks.gov.net\)](https://rks.gov.net)

**Tabela 12:** Emetimet në ajër për territorin e komunës së Pejës (Mg/vit)<sup>13</sup>

	Djegjet e vogla	Transporti rrugor	Industria	Bujqesia	Guroret	Pyjet	Total
<b>PM10</b>	1 040,41	188,43	29,49	53,83	1,60	0	1313,77
<b>PM 2.5</b>	1 013,60	84,49	26,89	8,84	0,16	0	1 133,98
<b>NOx</b>	105,43	657,08	214,19	158,57	0	0	1 135,28
<b>SO2</b>	37,84	0,31	305,28	0,11	0	0	343,53
<b>CO</b>	5 681,11	326,08	252,26	12,24	0	0	6 271,69
<b>NMVOC</b>	840,96	57,65	0	213,23	0	663,34	1 775,17

**Zhurma** - Burimet më të mëdha të ndotjes nga zhurma në Pejë vijnë nga trafiku dhe transporti rrugor, veprimtaritë e ndryshme të punës si aktivitetet e ndërtimit, gurëthyesit, pajisjet industriale. Komuna sipas Ligjit për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102 duhet të hartojë Planin e Veprimit dhe Hartën e zhurmës. Këto dokumente duhet të identifikojnë lokacionet që i nënshtrohen zhurmës, ti prezantojnë në hartë dhe bëjnë propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma. Komuna e Pejës nuk i posedon këto dy dokumente.

#### 4.3. Shfrytëzimi, ndotja dhe erozioni i tokave

Komuna e Pejës ka një sipërfaqe prej 60.259 ha, nga e cila 67% janë pyje dhe kullosa, 24% janë tokë e punueshme, 4.9% banim i ulët (shtëpi individuale dhe dyshe), 0.03% banim i lartë (objekte shumëbanesore), 0.31 % banim me funksione tjera, 0.24% shërbim tregtar, 0.06% industri dhe pjesa tjetër e territorit të komunës shfrytëzohet nga kategori të tjera si në tabelën më poshtë.

Toka në komunën e Pejës është e ndotur përreth deponisë në Sverk dhe disa deponive ilegale. Situata përkeqësohet pas reshjeve, kur rrjedhja nga këto deponi shkakton ndotjen e tokës. Gjithashtu shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve të cilat e kanë rolin mbrojtës, duke ndikuar në shkatërrimin e sipërfaqeve të tëra.

Degradimi i mëtutjeshëm shkaktohet edhe nga mihjet sipërfaqësore nga një numër i konsideruar i gurëthyesve, si dhe kompanive për eksploatimin e zhavorrit me ç'rast humbet toka bujqësore.

Rrezik tjetër permanent paraqesin vërshimet si pasojë e të reshurave, të cilat vërshojnë sipërfaqe të mëdha të tokës kualitative bujqësore të pambrojtur; shkaktojnë erozionin e sipërfaqes së tokave pyjore me bimësi të pakët, varfërimin e shtresës së humusit si dhe biodivesritetit.

<sup>13</sup> Projekti, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Cilësinë e Ajrit, ndryshimit të sjelljes dhe shërbimet e komunikimit: Azhurnimi i inventarit të emisioneve, MFK & AMMK 2021

Trendi i ndotjes dhe degradimit të tokës akoma është në rritje dhe si dukuri është më e theksuar përgjatë rrugëve kryesore lokale dhe regjionale. Përkundër miratimit të shumë ligjeve që e rregullojnë këtë fushë, Ligji për rregullimin e tokës (Nr. 04/L-040, 2012), Ligji për tokën bujqësore nr. 02/l-26 , rezultatet në parandalimin e degradimit mungojnë. Për më shumë edhe mungesa e monitorimit të vazhdueshëm rezulton me mungesë të të dhënave mbi nivelin e ndotjes, sipërfaqet e humbura të tokës bujqësore etj.

Në komunën e Pejës ekzistojnë dy hot spote të evidentuara në “Raportin e hotspoteve të Kosovës” 2012 si:

**Depoja e kemikateve industriale në Pejë**, objekti ku janë të deponuar kemikatet industriale të rrezikshëm dikur ishte pronë e Fabrikës së auto pjesëve në Pejë. Pas luftës kemikatet industriale janë grumbulluar nga njësitet e KFOR-it dhe janë vendosur në këtë objekt. Komuna dhe MMPH nuk posedojnë informata të sakta mbi origjinën, sasinë, llojin dhe rrezikshmërinë e këtyre substancave. KFOR-i i posedon këto informata, ajo e bënë monitorimin e vazhdueshëm të objektit. Depoja përfshinë sipërfaqe prej 0.12 ha.

**Deponia sanitare në Pejë** që ka sipërfaqe prej 4.85 ha. Edhe pse e ndërtuar sipas standardeve gjendja aktuale dhe menaxhimi i kësaj deponie është jo e mirë. Në këtë deponi bëhet përzierja e ujërave sipërfaqësore më rrjedhën që del nga deponia. Prania e metaleve të rënda, kemikateve dhe produkteve të vajrave në këtë deponi, bëjnë që ky lokacion të jetë burim potencial i ndotjes. Mos funksionimi i pompave të lagunës dhe mos mbulimi i mbeturinave bëjnë që gjendja në këtë deponi të shkojë drejt përkeqësimit edhe më të madh.<sup>14</sup>

**Tabela 13:** Hot spotet në komunën e Pejës

Nr.	Lokacioni	Aktiviteti	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metalet e rënda	Kimikate	Vajra	Materie organike	Të tjera
1.	Objekti i ish Fabrikës së automjeteve në Pejë	Depo për kemikate të rrezikshme industriale	0.12 ha	-	+	+	-	-
2.	Deponia Sanitare komunale në Pejë	Deponia e mbeturinave	4.85 ha	-	+	+	+	+

Erozioni është një fenomen që rrezikon tokën dhe ka të bëjë me gërryerjen, zhvendosjen dhe transportimin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor, kryesisht nën forcën e veprimit të ujit, akullit, erës dhe aktivitetit human. Efekti shkatërrues i tij është rezultat i faktorëve klimatik natyror, kryesisht i ndikuar nga sasia, lloji, intenziteti dhe kohëzgjatja e reshjeve, lloji dhe shkalla e mbulueshmërisë së tokës, pjerrtësia e terrenit dhe përbërja pedologjike si dhe nga

<sup>14</sup> Raporti i hotspoteve në Kosovë 2012

faktori njeri (prerja ilegale e pyjeve, nxjerrja e zhavorrit, mbi kullotja, veprat ndërtimore pa kriter si dhe politika e administrimit të ujërave (kanalizimet, veprat hidrike, pritrat etj.).

Dëmet e shkaktuara prej tij ndjehen jo vetëm në bujqësi, pylltari por dhe në fusha të tjera të ekonomisë, sikurse urbanistikë, transport, ndërtim dhe energjetikë. Kjo dukuri është prezente pothuaj në tërë territorin e komunës në forma dhe intensitet të ndryshëm. Zonat më të rrezikuara nga erozioni janë në: Radac, Dugaivë, Shtupeq i vogël, Kuçishtë etj.

**Tabela 14:** Erozioni sipas kategorive

Erozioni sipas kategorive	Sip. km <sup>2</sup>	%
Zonë pa erozion	41.4	6.9
Erozion shumë i dobët	110.2	18.3
Erozion i dobët	6.8	1.1
Erozion i mesëm	147.5	24.5
Erozion i forte	237.7	39.4
Erozion shumë i forte	59.4	9.9
<b>Total:</b>	<b>603</b>	<b>100</b>

Nga po të njëjtit faktor rrezikohet edhe qyteti i Pejës edhe nga erozioni dhe vërshimet janë të rrezikuara:

- Bashkësia territoriale Kapeshnica - zona e Zatrave e rrezikuar nga erozioni
- Bashkësia territoriale Xhemail Kada dhe 2 Korriku (Jarina Tabjet), zonë e rrezikuar nga erozioni dhe ujërat nëntokësore.
- Bashkësia territoriale Qendra - kanali i Seravisë, në të cilin derdhen kanalet nga pjesa veriore e qytetit, ekziston rreziku nga vërshimet në pjesën qendrore të qytetit.
- Bashkësia territoriale Dardania I dhe II- kanali i Dardanisë, kanali i jugut dhe proçkat tjera nga ana jugore paraqesin rrezik permanent nga vërshimet në këto bashkësi territoriale.

Dukuritë e jo stabilitetit të terrenit, të cilat kryesisht paraqiten në format e rrëshqitjeve dhe shembjeve, më të shprehura janë në Bjeshkët e Nemuna përkatësisht në zonën e Rugovës. Në bazë të kërkimeve të deritanishme gjeologo-inxhinierike të terrenit mund të konkludohet se pjesa më e madhe e zonave jo stabile janë të lidhura me ndërtimin gjeomorfologjik të terrenit mbi bazën e të cilave është ndërtuar harta me zona me potencial gjeo-rreziku.

Rrëshqitjet janë të shprehura në sezonin pranveror-mars dhe prill, sezonin vjeshtor -tetor, nëntor dhe dhjetor si dhe sezonin dimëror -janar dhe shkurt.

Në mungesë të mbrojtjes institucionale, nga shfrytëzimi pa kriter i tokës bujqësore, veçanërisht gjatë ndërtimit të infrastrukturës apo eksplotimit të materialeve inerte, në shumë raste toka ka pësuar degradim të pa riparueshëm. Humbja e tokës bujqësore manifestohet në forma të ndryshme:

- Humbjet e përhershme të tokës bujqësore: vendbanimet, veprimtaritë komerciale, bizneset, etj.;
- Humbjet e përkohshme të tokës bujqësore: mihjet sipërfaqësore, eksploatimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës, deponitë e automjeteve, procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve, etj.

Një ndikim tjetër është edhe shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjëve. Gjatë vitit 2022 AMMK ka monitoruar këtë dukuri ku janë monitoruar edhe lumenjtë Drinin e Bardhë dhe Lumëbardhin e Pejës.

Gjatë monitorimit të lumenjve janë identifikuar forma të ndryshme të degradimit si pasojë e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit. Si vlerësim i gjendjes mjedisore janë marrë në konsideratë karakteristikat e mundshme fizike natyrore të shtretërve të lumenjve dhe format e degradimit të lumit të rezultuar nga nxjerrja e rërës dhe zhavorrit.

Të gjeturat e evidentuara nga monitorimi janë<sup>15</sup>:

- Ndryshimi fizik i rrjedhës së lumenjve dhe zgjerimi i pakontrolluar i shtretërve;
- Devijim i rrjedhës natyrore të ujërave;
- Nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit janë krijuar thellësira dhe hendeqe të shumta gjatë rrjedhës së lumenjve;
- Me degradimin e shtretërve të lumenjve është rritur shkalla e erozionit të tokës dhe vërshimeve;
- Ndërprerjet parciale të lumit dhe zvogëlimin e minimumit biologjik të rrjedhës së ujërave;
- Shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit për tej masave të rikthimit natyrore nga lumenjtë;
- Degradim të sipërfaqeve të tokës përgjatë shtretërve të lumenjve;
- Paqëndrueshmëri dhe prishje e brigjeve të lumit;
- Ndikimi në ndryshimin natyror të ekosistemit të lumit, florës dhe faunës.

---

<sup>15</sup> Raport - Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve, AMMK 2022



Foto: Dëmtimi i shtratit të lumit në Lumbardhin e Pejës

#### 4.4. Menaxhimi i mbeturinave

Bazuar në Ligjin për mbeturina (Ligji 04/l-60), dhe Rregulloren Komunale për Menaxhim të Mbeturinave, komuna e ka të krijuar sistemin për menaxhim të mbeturinave për territorin e vet. Për më tepër, në vitin 2016 komuna e Pejësë ka miratuar “Planin për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2020” zbatimi i të cilit bëhet përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektoratit Komunal për Mjedis. Aktualisht komuna e Pejës është në proces të rishikimit të Planit për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale.

Në komunën e Pejës grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave e kryen Kompania Rajonale “Ambienti”. Mbledhja e mbeturinave bëhet në dy mënyra: kryerja e shërbimit me kontejnerë 1,1 m<sup>3</sup> dhe 7 m<sup>3</sup> dhe kryerja e shërbimit derë me derë (shtëpi për shtëpi). Rrjeti i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në Pejë është 600km, me 400 kontejnerë të vëllimit 1,1 m<sup>3</sup> dhe 15 të vëllimit 7 m<sup>3</sup>.

Sipas të dhënave nga AMMK Komuna e Pejës ka mbulueshmëri me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për ekonomi familjare në shkallë prej 93.7%. Në vitin 2021 në territorin e komunës janë grumbulluar gjithsejt 36,063.00 ton mbeturina, ndërsa gjenerimi për kokë banori ishte 391.97 kg/vit. Në tabëlën 15 janë prezantuar treguesit kryesorë të menaxhimit të mbeturinave për komunën e Pejës.

**Tabela 15:** Treguesit e menaxhimit të mbeturinave në komunën e Pejës (2021)<sup>16</sup>

Numri i banorëve (ASK 2011)	96,450.00
Numri i banorëve të shërbyer	88,829.78
Numri i ekonomive familjare (ASK 2011)	17,682.00
Numri i ekonomive familjarë të shërbyera (2021)	16,867
Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2021)	93.7 %
Numri i bizneseve aktive në komunë (2021)	2,737
Numri i bizneseve që pranojnë shërbimin (2021)	2,701
Shkalla e mbulimit me shërbim për biznese (2021)	98.7%
Numri i institucioneve në komunë 2021	103
Numri i institucioneve që pranojnë shërbimin (2021)	103
Shkalla e mbulimit me shërbim për institucione (2021)	100%
Mbeturina të grumbulluara ton/vit	36,063.00
Mbeturina të grumbulluara kg/vit	36,063.000.00
Gjenerimi i mbeturinave komunale kg/vit	391.97
Gjenerimi i mbeturinave komunale kg/dit	1.07

Mbeturinat deponohen në deponinë rajonale në Sferkë, e cila ka kapacitet prej 1.500.000 m<sup>3</sup>. Deponia është e ndërtuar në vitin 2001, me sipërfaqe prej 3.6 ha. Kjo deponi shërben për deponimin e mbeturinave nga Komuna së Pejës, Klinës, Deçanit dhe Istogut. Të dhënat e viti 2020 tregojnë se në deponinë rajonale në Sferkë janë deponuar 52,496.00 t/vit, që shënon trend rritje krahasuar me vitin paraprak. Edhe pse e ndërtuar sipas standardeve, gjendja aktuale dhe menaxhimi i kësaj deponie nuk është i mirë, për shkak të përzjerjes së ujërave sipërfaqësore me rrjedhën që del nga deponia. Mos funksionimi i pompave të lagunës dhe mos mbulimi i rregulltë i mbeturinave janë problemet kryesore me menaxhimin e kësaj deponie e cila aktualisht është në fund të kapacitetit deponues.

Deponitë ilegale të mbeturinave janë një ndër problemet kryesore të menaxhimit të mbeturinave në komunë. Në vitin 2021 janë evidentuar 21 deponi ilegale të mbeturinave, nga te cilat deponi të mbeturinave komunale ishin (41%), deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit (5%) dhe 53% ishin deponi me mbeturina tjera. Sipas madhësisë, 7 deponi ilegale janë kategorizuar si të mëdha, 7 deponi të mesme dhe 7 deponi të vogla.

<sup>16</sup> Raporti i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë për vitin 2020, AMMK 2021



Ndërsa spitali dhe objektet tjera shëndetësore krijojnë sasi të mëdha të mbeturinave medicinale, të cilat në komunën e Pejës arrijnë masën prej rreth 27 t në vitë nga të cilat 30% digjen në furrën djegëse dhe pjesa tjetër hidhet me mbeturina tjera.

Edhe në komunën e Pejës, sikurse në shumicat e komunave të Kosovës, degja e hapur e mbeturinave apo edhe përdorimi i mbeturinave për ngrohje është një dukuri që ndodhë. Ky proces është burim i ndotjes së ajrit dhe shkarkimeve në ajër.

Në funksion të përmirësimit të cilësisë së ajrit Komuna e Pejës, duhet të angazhohet në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të deponuara në deponi sanitare, në eliminimin e deponive ilegale dhe në parandalimin e djegjes së mbeturinave.

#### 4.5. Natyra dhe biodiversiteti

Trashëgimia natyrore i referohet biodiversitetit duke përfshirë florën dhe faunën, ekosistemet dhe strukturat gjeologjike. Atraksionet që konsiderohen potencial për zhvillim të turizmit, zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura në Komunën e Pejës sipas kategorive, rëndësisë, vendit dhe sipërfaqes janë të paraqitura në tabelën nën në vazhdim<sup>17</sup>.

**Tabela 16:** Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura<sup>18</sup>

Emërtimi i Zonës/Objektit	Sipërfaqja në ha	Viti i mbrojtjes	Kategoria e mbrojtjes	Përshkrimi i vlerave
Gubavci	38	1959	II Rezervat	Rezervat bimor i llojit endemorelikt (Fosythia europeae)
Burimi i Drinit të Bardhë me shpellën dhe ujëvarën në Radac	90	1983	III Monument natyror	Monument natyrore me rëndësi gjeomorfologjike, hidrologjike dhe turistike
Gryka e Rugovës	4.300	1985		Rëndësi gjeologjike, hidrologjike, pejsazhore, speleologjike, botanike
Mani Sham (Morus sp.)		1957		Monument natyror me karakter botanik
Maja e zezë	11.250	1977		Monument memorial i natyrës

<sup>17</sup> MMPH- Vlerat e Trashëgimisë Natyrore të Kosovës

<sup>18</sup> Burimi: Raporti për gjendjen e natyrës 2010-2014

**Gryka e Rugovës** – si Monument Natyror është evidentuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura, paraqet pjesën më piktoreske të Bjeshkëve të Nemuna dhe karakterizohet me shkëmbinj të lartë gëlqeror me numër të madh të shpellave si dhe me lloje bimore, reliktoke dhe endemorelike.

**Drini i Bardhë** – Burimi i Drinit të Bardhë është burimi më i fuqishëm i ujit në Kosovë dhe bashkë me Shpellën e Radavcit janë vënë nën mbrojtje në vitin 1983, si monumente natyrore me sipërfaqe prej 89.94 ha. Shpella dhe Burimi i Drinit të Bardhë gjenden afër fshatit Radavc, rreth 11 km larg qytetit të Pejës, pranë rrugës Pejë-Rozhajë. Këto dy bukuri të trashëgimisë natyrore gjenden në pjesën verilindore të vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna. Aktualisht, karakteristikë e veçantë janë ndërhyrjet që kryesisht janë realizuar në Burimin e Drinit të Bardhë rreth Ujëvarës, të cilat konsistojnë me ndërtimin e shtigjeve për vizitorë, shkallëve, vendosjen e kiosqeve, ndërhyrjet në rregullimin e rrjetit për nevojat e hidrocentralit dhe furnizimit të popullsisë me ujë të pijshëm, dhe mbishfrytëzimi i ujit nga ana e hidrocentralit i cili ndikon drejtpërdrejt në uljen drastike të sasisë së ujit në ujëvarë.

**Gubavci** – është rezervat strikt i natyrës që nga viti 1959, me sipërfaqe prej 38.24 ha, gjendet në pjesën perëndimore të Pejës, duke krijuar një pamje mjaft imponante rrëzë Koprivnikut.

**Maja e Zezë** – është monument memorial i natyrës me një sipërfaqe prej 112,50 ha, e përfshirë në listën e mbrojtjes që nga viti 1977. Është vend që vizitohet shpesh nga ana e turistëve për paraglajding dhe mund të konsiderohet si potencial për zhvillime të ardhshme.

Është e njohur që rëndësia e vlerave të mbrojtura të natyrës dhe atyre të trashëgimisë kulturore në zhvillimin lokal është në rritje. Asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit dhe veprimtarive ekonomike të ndërlidhura me të, duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe të hyrave për popullsinë lokale. Gërshetimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore është njëra ndër karakteristikat më të rëndësishme të komunës së Pejës, dhe roli i tyre në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës është i pamohueshëm.

Më shumë se gjysma e territorit të Komunës është pjesë e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” vlerat e të cilit duke përfshirë llojlojshmërinë biologjike dhe të peizazhit i tejkalojnë kufijtë e vendit tonë. Brenda këtij territori përfshihen edhe një numër i konsiderueshëm i monumenteve kulturore me status të mbrojtjes si: Patrikana e Pejës e shpallur si "Zonë e veçantë e mbrojtur" (ZVM), gërmadha të fortifikatës në fshatin Lipë, shpella e murgjve në grykën e Rugovës (e njohur si shpella e mbretneshës), gërmadhat e kishës së Katarinës në Lipë dhe kisha në Kuqishtë.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> PH i PK “Bjeshkët e Nemuna”, IPH/MMPH

PH i PK “Bjeshkët e Nemuna” i ka identifikuar për pjesën e Pejës 3 zona me potenciale turistike: Zona turistike e Kopranikut: Lokaliteti turistik Bjeshka e Irzniqit, Zona turistike e Rugovës me Lokalitetet turistike: Gryka e Rugovës, Bjeshka e Lumbardhit, Liqenati, Boga dhe Drelaj; Zona turistike e luginës së Drinit: Lokaliteti turistik i Burimit të Drinit – Radavci. Rugova është qendra më e frekuentuar e masivit të Bjeshkëve të Nemuna ku mund të zhvillohen aktivitete gjatë gjithë vitit si: qëndrimi në natyrë të lirë, turizmi fshatar, turizmi shëndetësor, ngjitjet në shkëmbinj - alpinizëm, ecjet malore, eksplorimet në shpella, çiklizmi malor, ecjet me shputa bore, skijimi, etj.

Me llojlojshmërinë e peizazheve mbresëlënëse natyrore dhe kulturore, PK “Bjeshkët e Nemuna” ofron edhe mundësinë e zhvillimit të turizmit ndërkufitar Kosovë-Mali i Zi-Shqipëri.

Bashkëpunimi ndërkufitar konsiston në turizmin malor, shtegun turistik “Majat e Ballkanit”, shtigjet që lidhin këto tri shtete nëpër viset më të larta dhe fshatrat e largëta malore të Bjeshkëve të Nemuna.

Këto aktivitete kanë ndikim direkt në ngritjen ekonomike të banorëve të fshatrave të këtyre zonave, përmes ofrimit të bujtinave (shtëpive malore të adaptuara për akomodim të turistëve), ushqimit etj.

Mundësitë për bashkëpunim ndërkufitar mes tri shteteve-Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi janë të mëdha, pasi që këtë e mundëson pozita e cila i lidh ato me zonat përtej kufijve si:

- Lugu i Shkodrës (lidh Rugovën me Tropojën dhe Shkodrën);
- Qafa e Çakorrit që të qon në Plavë e Guci (Mali i Zi);
- Qafa e dasmorëve në veri të fshatit Bogë që lidhë Rugovën me Buxhovin e Rozhajen (Mali i Zi);
- Qafa e Hajles është rruga kryesore që lidhë Malësinë e Rugovës (fshatrat Dacaj dhe Husaj ) me Rozhajën (Malin e Zi).
- Guri i Ndre Nikës (Shtedim) me gjatësi prej 5 km si vend i përshtatshëm për skijim shtrihet në dy hapësira territoriale të Kosovës dhe Malit të Zi.<sup>20</sup>

#### **4.6. Shëndeti Publik**

Hulumtimet shkencore kanë vërtetuar ndikimet në shëndetin publik nga ndotja e ajrit dhe në veçanti nga grimcat (PM). Efektet kryesore të PM në shëndetin publik janë sëmundjet respiratore dhe efektet kardiovaskulare. Efektet që i atribuohen ekspozimit afatgjatë përfshijnë mortalitetin për shkak të sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore, sëmundjeve kronike respiratore (astma, sëmundjet kronike obstruktive të mushkërive, dhe ndryshimet kronike patologjike), kanceri i mushkërive, sëmundjet kronike kardiovaskulare, dhe pengesat në rritjen intrauterine sikur është për shembull pesha e ulët në lindjen normale.

<sup>20</sup> PH i PK “Bjeshkët e Nemuna”, IPH/MMPH

Në kuadër të vlerësimit të ndikimeve të gjendjes së mjedisit në shëndetin publik, janë analizuar edhe shkaqet e vdekjes në komunën e Pejës për vitet 2018-2019. Nga të dhënat e prezantuara në tabelën 17, vërehet që shkaqet e vdekjes që kanë predispozita të ndërlidhen me gjendjen e mjedisit sikurse janë tumoret, sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes dhe sëmundjet e sistemit të qrkullimit të gjakut, kanë pasur trend të rritjes dhe janë të përfaqësues me përqindje më të lartë se sa shkaqe tjera të vdekjes.

Sipas raportit Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë, në Komunën e Pejës gjatë vitit 2022 janë regjistruar 202 persona si raste të reja me sëmundjet malinje dhe beninje, ndërsa që 276 persona janë trajtuar me sëmundjet malinje dhe beninje. 17 persona janë regjistruar me sëmundje të turbekulozit, ndërsa që në vitin 2021 ishin regjistruar 22 persona me TBC. Numri i pacientëve të regjistruar me sëmundje ngjitëse nga Komuna e Pejës në vitin 2022, ishte 5593, ku me sëmundj të vricelës kanë qenë 142, me influencë 2494, me diare akute 2742 dhe me varicele 215 persona.

**Tabela 17:** Shkaqet e vdekjeve në komunën e Pejës (2018-2019)<sup>21</sup>

Diagnoza (shkaku i vdekjes )	2018		2019	
	Numri	%	Numri	%
Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	216	36,7	225	52,2
Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	10	1,7	23	5,3
Tumoret	81	13,8	93	21,6
Sëmundjet e sistemit urogjenital	18	3,1	10	2,3
Disa gjendje me origjinë në periudhën perinatale	6	1,0	3	0,7
Shkaktarët e jashtëm të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë	8	1,4	14	3,2
Sëmundjet endokrine, të ushqyshmërisë dhe metabolike	12	2,0	15	3,5
Simptomët, shenjat dhe rezultatet jonormale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara gjetiu	224	38,1	19	4,4
Sëmundjet tjera	13	2,2	39	9
<b>Gjithsej</b>	<b>588</b>	<b>100</b>	<b>431</b>	<b>100</b>

<sup>21</sup> Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë 2018-2019, ASK 2020

## 5. Problemet kryesore mjedisore

**Tabela 18:** Problemet kryesore mjedisore

Përshkrimi i problemeve kryesore mjedisore sipas sektoreve
<b>Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Degradimi i shtretërve të lumenjëve si rezultat i aktiviteteve minerale legale dhe ilegale;</li> <li>• Cilësi e dobët e ujërave sipërfaqësore në disa zona;</li> <li>• Qasja në rrjetin e ujësjellësit ende nuk është ofruar për të gjitha ekonomitë familjare;</li> <li>• Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura në zonat rurale.</li> <li>• Mungesa e trajtimit të ujërave industriale;</li> <li>• Ndotja e ujërave si rezultat i aktiviteteve bujqësore dhe përdorimit të plehrave kimike dhe organike;</li> <li>• Humbja e biodiversitetit në ekosistemet ujore si rezultat i ndotjes së ujërave nga ndotja urbane, bujqësore dhe industriale;</li> <li>• Degradimi i lumenjëve si rezultat i ndërtimeve infrastrukturore për nevoja të prodhimit të hidro-energjisë;</li> <li>• Ndotja e lumnejeve nga deponitë ilegale të mbeturinat.</li> </ul>
<b>Ajri dhe zhurma</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e Planit Lokal për Mbrojtje nga Zhurma;</li> <li>• Djegijet e vogla (amvisërit, shërbimet dhe ndërtesat publike) janë burim kryesor i ndotjes me Grimaca të Pluhurit (PM10 dhe PM 2.5) dhe me Monoksin Karboni (CO), si rezultat i përdorimit të lëndëve djegëse fosile për ngrohje dhe përdorimit të stufave dhe furrave joefikase;</li> <li>• Trafiku është burimi kryesor i ndotjes me NOx si rezultat i qarkullimit të automjeteve të vjetra në komunikacion</li> <li>• Janë identifikuar edhe disa gurëthyesit si burime potenciale të emetimit të grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2.5.</li> <li>• Mungesa e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore.</li> <li>• Izolimi jo efikas i ndërtesave rrit konsumin e energjisë dhe ndikon në rritjen e emetimeve në ajër.</li> </ul>
<b>Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Humbja e përkohshme dhe e përheshme e tokës bujqësore me cilësi të lartë e shkaktuar nga zgjerimi i vendbanimeve, ndërtimet ilegale ndërtimi i rrugëve dhe aktivitetet ekonomike;</li> <li>• Ndotja e tokës/dheut nga deponitë e mbeturinave komunale, mbeturinat industriale dhe nga aktivitetet ekonomike;</li> <li>• Ndërrimi i destinacionit të tokave bujqësore dhe fragmentimi i parcelave dhe tokave bujqësore;</li> <li>• Degradimi i tokës dhe ekosistemeve tokësore nga aktivitetet minerare dhe erozioni;</li> </ul>

- Mungesa e planeve të rregulluese për mbrojtjen e tokave bujqësore nga ndërrimi i destinimit dhe fragmentimi;
- Mossqarimi i kompetencave ndërmjet organeve përgjegjëse për menaxhim të tokës;
- Mungesa e mjeteve financiare për rehabilitimin dhe rikultivimin e minierave të braktisura të cilat paraqesin rrezik të përhershëm për erozion dhe për njerëzit;

### **Menaxhimi i mbeturinave**

- Kapacitetet e pamjaftueshme të deponisë sanitare në Sferkë për deponimin e mbeturinave dhe gjendja jo e mirë e deponisë;
- Menaxhim jo efikas i mbeturinave në hapësira publike;
- Përfshirja jo e plotë e ekonomive familjare në sistemin e grumbullimit të mbeturinave;
- Deponi ilegale të mbeturinave në disa zona të komunës;
- Nivel i ulët i ndarjes, reciklimit dhe kompostimit të mbeturinave;
- Promovimi i ulët i parimeve të ekonomisë qarkore dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve;
- Kapacitete të limituara teknike për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave;
- Niveli i ulët i vetëdijësimit për menaxhimin e mbeturinave komunale;

### **Natyra dhe biodiversiteti**

- Mungesa e Programit Lokal për Mbrojtjen e Biodiversitetit;
- Mungesa e planeve menaxhuese për zonat e mbrojtura të natyrës;
- Mungesa e planeve për menaxhimin e pyjeve të ulëta që janë në kompetencë të komunës;
- Mbrojtje jo e mjaftueshme e biodiversitetit dhe e peizazhit natyror;
- Degradimi i pyjeve nga prerjet ilegale dhe aktivitetet tjera;
- Degradimi i habitateve natyrore dhe i peizazhit si rezultat i aktiviteteve të njeriut dhe veprimtarive ekonomike;
- Ndërtimi i infrastrukturës turistike dhe objekteve akomoduese në zonat e mbrojtura pa i respektuar rregullat mjedisore;
- Buxheti i pamjaftueshëm për mbrojtjen e natyrës;
- Qëndrimi pasiv i qytetarëve ndaj biodiversitetit dhe vetëdijësi jo i mjaftueshëm për mbrojtjen e natyrës;
- Mungesa e fondeve për edukimin mbi biodiversitetin, programeve dhe materialeve për edukimin mbi biodiversitetin.

### **Të përgjithshme**

- Niveli i ulët i vetëdijes mjedisore;
- Pjesëmarrje e ulët e publikut në vendimmarrjen mjedisore;
- Mungesa e planeve lokale për zhvillimin e turizmit dhe promovimit të ekoturizmit.
- Mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional dhe OJQ-ve për mbrojtjen e mjedisit.
- Zbatim i pamjaftueshëm i VSM-së dhe VNM-së për planet, programet dhe projektet e nivelit lokal;
- Numri i vogël i inspektorëve për sektorin e mjedisit.

- Buxheti i limituar në sektorin e mbrojtjes së mjedisit.
- Mungesa e kapaciteteve për qasje në fondet ndërkombëtare për mjedisin dhe kapaciteti i ulët absorbues.
- Infrastruktura e pamjaftueshme turistike – mungesa e rrugëve në disa zona, mungon shënjimi turistik, hartat, qendrat informative turistike etj.
- Mungesa e një plani lokal për ndryshimet klimatike;
- Mungesa e investimeve për projektet e zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes së ndryshimeve klimatike.

## 6. Prioritetet mjedisore për periudhën 2024-2028

Tabela 19: Prioritetet mjedisore për periudhën 2024-2028

<b>Përshkrimi i prioriteteve kryesore mjedisore sipas sektorëve</b>	
<b>Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të zeza dhe atyre atmosferike për të gjitha vendbanimet e komunës.</li> <li>• Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore përmes ngritjes së kapaciteteve për trajtimin e ujërave të ndotura urbane në zonat ruarale dhe ujërave të ndotura industriale;</li> <li>• Rritja e cilësisë dhe sasisë së ujit të pijes përmes përmirësimit të sistemit të ujësjellësit në zonat urbane dhe rurale.</li> <li>• Mbrojtja nga vërshimet dhe përmbytjet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve.</li> <li>• Vetëdijësimi i farmerëve për reduktimin e ndotjes së ujërave nga bujqësia dhe menaxhimin e qëndrueshëm të plehrave;</li> <li>• Pjesëmarrja në zbatimin e planit menaxhues për pellgun e lumit Drini i Bardhë;</li> </ul>	
<b>Ajri dhe zhurma</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i cilësisë së ajrit përmes reduktimit të burimeve nga djegiet e vogla;</li> <li>• Mbështetja dhe subvencionimi i ekonomive familjare dhe shërbimeve për ndërrimin e lëndëve djegëse dhe pajisjeve për ngrohje;</li> <li>• Mbështetja dhe subvencionimi i ekonomive familjare për izolimin e ndërtesave dhe eficientësinë e energjisë;</li> <li>• Përmirësimi i informimit dhe rritja e vetëdijësimit për mbrojtje nga ndotja e ajrit;</li> <li>• Hartimi dhe zbatimi i planit të mobilitetit për territorin e komunës së Pejës;</li> <li>• Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtje nga Zhurma;</li> <li>• Mirëmbajtja dhe pastrimi i infrastrukturës rrugore për zvogëlimin e emetimeve të pluhurit;</li> <li>• Mbështetja dhe subvencionimi i bizneseve për zëvendësimin e pajisjeve jo eficiente dhe vendosjen e filtrave për reduktimin e ndotjes së ajrit;</li> </ul>	

- Inventarizimi gjithëpërfshirës i emetimeve që i mbulon të gjitha burimet dhe llojet e ndotjes së ajrit, duke i dhënë prioritet sektorit të djegieve të vogla;
- Zbatimi i gjobave për ndotësit që në mënyrë të qëllimshme rrisin shkarkimet në mjedis përmes djegieve të hapura dhe të mbyllura;
- Mbështetja dhe subvencionimi i iniciativave për zhvillim të energjisë së ripërtëritshme nga era dhe dielli duke marrë parasysh standardet mjedisore;
- Rritja e numrit të automjeteve hibride me standarde më të larta Euro në floten komunale
- Hartimi i projektit të ngrohjes qëndore në zonën urbane dhe zbatimi i kërkesave për sistemet e ngrohjes tek ndërtesat e reja kolektive;
- Rritja e vetëdijësisë dhe informimit për mbrojtje nga ndotja e ajrit dhe mbrojtja e shëndetit nga ndotja e ajrit;
- Zbatimi i veprimeve dhe aktiviteteve në rastet e emergjencave të tejkalimeve të normave të cilësisë së ajrit;
- Fuqizimi institucional për menaxhimin e ndotjes së ajrit dhe zbatimin e planeve dhe rregulloreve për reduktimin e ndotjes.

#### **Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut**

- Mbrojtja e tokës bujqësore me cilësi të lartë nga zgjerimi i vendbanimeve, ndërtimet ilegale, ndërtimi i rrugëve dhe aktivitetet ekonomike;
- Mbrojtja e tokës nga erozioni dhe nga aktivitetet ilegale minerare;
- Ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo-direkte dhe në mënyrë specifike nga deponitë e mbeturinave komunale, mbeturinat industriale dhe nga aktivitetet ekonomike;
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore;
- Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e agroturizmit dhe bujqësisë organike.
- Hartimi i planeve të rregulluese dhe programeve monitoruese për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe mbrojtjen e cilësisë së dheut.
- Ndarja e buxhetit dhe subvencioneve për rehabilitimin dhe rikultivimin e minierave të braktisura të cilat paraqesin rrezik të përhershëm për erozion dhe për njerëzit;

#### **Menaxhimi i mbeturinave**

- Rehabilitimi dhe zgjerimi i kapacitetit të deponisë sanitare të mbeturinave në Sferkë;
- Përmirësimi i sistemit për grumbulimin e mbeturinave përmes zhvillimit të infrastrukturës për menaxhim të mbeturinave, dhe përfshirjes së vendbanimeve në sistem të menaxhimit të mbeturinave.
- Rritja e nivelit dhe mundësive për ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave;
- Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe menaxhimi efikas i mbeturinave në hapësira publike;



- Organizimi i fushatave të vetëdijësimit për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Promovimi i parimeve të ekonomisë qarkore dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve;
- Zbatimi i gjobave dhe masave ndëshkuese për hudhjen e pakontrolluar të mbeturinave në hapësira publike dhe në natyrë.

### **Natyra dhe biodiversiteti**

- Mbrojtja e biodiversitetit dhe peisazheve të vlefshme natyrore në hapësirën e komunës së Pejës përmes shpalljes së zonave të mbrojtura;
- Shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrorë dhe promovimi i vlerave natyrore;
- Revitalizimi i ekosistemeve malore në pjesë të ndryshme të Pejës;
- Mbrojtja dhe menaxhimi e pyjeve dhe parandalimi i prerjes së pyjeve;
- Ndalimi i gjetisë ilegale dhe veprimeve që e dëmtojnë natyrën dhe biodiversitetin.
- Shënjimi i monumenteve dhe zonave të natyrës me tabela informuese;
- Hartimi i Programit Lokal për Mbrojtjen e Biodiversitetit;
- Hartimi i planeve menaxhuese për zonat e mbrojtura të natyrës;
- Hartimi i planeve për menaxhimin e pyjeve të ulëta që janë në kompetencë të komunës;
- Hartimi i planeve lokale për zhvillimin e turizmit dhe promovimit të ekoturizmit.
- Fuqizimi i menaxhimit të pyjeve dhe bashkëpunimit për zvogëlimin e prerjeve ilegale dhe aktivitet tjera që kanë ndikim negativ në natyrë;
- Ndërtimi i infrastrukturës turistike dhe objekteve akomoduese në zonat e mbrojtura duke respektuar rregullat mjedisore dhe kërkesat e VNM;
- Rritja e buxhetit për mbrojtjen e natyrës dhe kapaciteteve për qasje në fondet ndërkombëtare;
- Organizimi i fushatave të vetëdijësimit për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;

### **Të përgjithshme**

- Parandalimi i efekteve mjedisore nga zhvillimet e reja negative;
- Ngritja e vetëdijes mjedisore dhe nxitja e pjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore;
- Fuqizimi i inspektoratit për implementimin e legjislacionit në fushën e mjedisit;
- Rritja e buxhetit dhe investimeve për sektorin e mjedisit.
- Përfshirja dhe integrimi i mbrojtjes së mjedisit në plane komunale dhe në strategji të tjera sektoriale që kanë ndikim në mjedis.
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucionale për mbrojtjen e mjedisit;
- Hartimi i planit komunal për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe trajnimi i cicëronëve për turizmin e qëndrueshëm.
- Hartimi i planit lokal për ndryshimet klimatike;

## 7. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2024-2028

**Tabela 20:** Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2024-2028 dhe përgjegjësit për implementim

Prioritetet	Aktiviteti/Veprimi	Buxheti Euro dhe burimi	Përgjegjësi për implementim	2024				2025				2026				2027				2028											
				1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4								
<b>Mbrojtja e resurseve ujore dhe menaxhimi efikas i tyre</b>	Ngritja e infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të zeza dhe atyre atmosferike për të gjitha vendbanimet e komunës.	2,629.271.00	KRU Hidro Drini		x				x				x																		x
	Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura urbane në Terstenik	450.000.00 Komuna MMPHI Donatorët	KRU Hidro Drini										x																		
	Rregullimi i shtretërve të lumenjëve për mbrojtje nga vërshimet dhe përmytjet	400.000.00	Komuna, MMPHI			x			x				x																		
	Zgjerimi i infrastrukturës për furnizim me ujë të pijes	500.000.00	KRU Hidro Drini			x			x																						x
	Fushatë vetëdijësimi për mbrojtje nga përmytjet dhe vërshimet	10.000.00	Komuna, MMPHI				x		X																						
	Pjesëmarrja në zbatimin e veprimeve të Planit Menaxhues për Pellgun e Lumit Drini i bardhë	500.000.00	Komuna, MMPHI				x																x								
	Fushatë vetëdijësimi për farmerët për reduktimin e ndotjes së ujërave nga bujqësia	10.000.00	Komuna, MMPHI KRU Hidro Drini			x			X																						
<b>Përmirësimi i cilësisë së ajrit</b>	Subvencionimi i familjeve për ndërrimin e lëndëve djegëse me ndotje të lartë me ato me ndotje të ulët	PLVCA Komuna ME	Komuna ME		x																										x
	Subvencionimi i familjeve për ndërrimin e pajisjeve jo eficientë me ato eficientë	PLVCA Komuna ME	Komuna ME		x																										x

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028

	Subvencionimi i familjeve për ndërrimin e sistemeve të ngrohjes jo eficente me ato eficente	PLVCA Komuna ME	Komuna ME	x																	x
	Hartimi i planit të mobilitetit për komunën e Pejës	20.000.00 Komuna	Komuna, DSHP		x			x													
	Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve për zvogëlimin e emetimeve të pluhurit	20.000.00 Komuna	Komuna, DSHP	x																	x
	Inventarizimi i burimeve të ndotjes siaps sektorëve në komunën e Pejës	100.000.00 Komuna, Donatorët	Komuna, DUMM			x				x											
	Zbatimi i gjobave për djegiet e hapura të mbeturinave dhe djegiet tjera	Komuna	Komuna, DI		x																x
	Rritja e numrit të automjeteve të hibride dhe elektrine në flotën e komunës dhe në transportin publik	Komuna, Operarotët e Transportit	Komuna			x							x								
	Mbështetja dhe subvencionimi i iniciativave për shfrytëzim të burimeve të ripërtristshme të energjisë	Komuna, ME, Bizneset	Komuna, ME,	x																	x
	Hartimi i projektit për ndërtimin e rrjetit të ngrohjes qendrore për zonën urbane të qytetit	Komuna, ME, Donatorët	DSHP	x				X													
	Ngritja e vetëdijësimit dhe informimit për mbrojtje nga ndotja e ajrit dhe mbrojtjes së shëndetit nga ndotja	Komuna, OJQ, Donatorët	OJQ, DKA	x																	x
<b>Reduktimi i zhurmës</b>	Hartimi i planit lokal për zhurmë	20.000.00 Komuna	Komuna/DUMM				x		x												
	Përcaktimi i zonave të zhurmës në zonën urbane të qytetit	10.000.00 Komuna	Komuna/DUMM							x	x										
<b>Ndryshimet klimatike</b>	Hartimi i Planit Lokal per Energji dhe Klimë	100.000.00 Komuna, Donatorwt	Komuna/DUMM	x			x														
	Zbatimi i veprimeve për zbutje të ndryshimeve klimatike nga Plani Lokal	Komuna, Donatorët	Komuna/DUMM					X													

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028

	për Energji dhe Klimë																							
	Zbatimi i veprimeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike nga Plani Lokal për Energji dhe Klimë	Komuna, Donatorwt	Komuna/DUMM						X														X	
<b>Shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës dhe përmrësimi i cilësisë së dheut</b>	Rehabilitimi dhe rikultivimi i minierave të braktisura të shfrytëzimit të resurseve minerare	Komuna KPMM ME	Komuna DB	x																			x	
	Mbrojtja e tokës nga erozioni	Komuna	Komuna DB	x																			x	
	Rehabilitimi i hot-spotëve mjedisore nga ndotja industriale	Komuna, MMPHI	Komuna						x								x							
	Hartimi i planit për mbrojtjen e tokës bujqësore me cilësi të lartë	20.000.00 Komuna	Komuna, DB			x				x														
	Inventarizimi i burimeve të ndotjes së tokave	50.000.00 Komuna, Donatorët	Komuna, DUMM				x				x													
	Mbështetja dhe subvencionimi i iniciativave për bujqësi organike dhe agroturizëm	Komuna, MBPZHR, AZHB	Komuna, DB		x																			x
<b>Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave</b>	Rehabilitimi dhe zgjerimi i kapacitetit të deponisë sanitare të mbeturinave në Sferkë	8.000.000.00 Komuna, MMPHI, BE	MMPHI, KRM Ambienti		x								x											
	Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	PLMM	DSHP KRM Ambienti	x													x							
	Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave	PLMM	DSHP KRM Ambienti		x																		x	
	Menaxhimi (mbledhja) e mbeturinave në hapësira publike	PLMM	DSHP, ECO		x																		x	
	Ngritja e infrastrukturës për ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave	PLMM	DSHP, KRM Ambienti			x																x		

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028

	Zbatimi i gjobave dhe masave ndëshkuese për hedhjen e pakontrolluar të mbeturinave	PLMM	DI, Policia e Kosovës	x														x				
	Promovimi i parimeve të ekonomisë qarkore në menaxhimin e mbeturinave	PLMM	DSHP, OJQ, MMPHI		x				X													
	Fushatë vetëdijësimi për menaxhimin e mbeturinave komunale	PLMM	DSHP, OJQ, MMPHI		x				X													
<b>Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit</b>	Marrja në mbrojtje e zonave të reja të natyrë	Kosto administrative	Komuna, DUMM	x	x																	
	Revitalizimi i eksosistemeve natyrore të degraduara	100.000.00 Komuna, APK	Komuna, DB			x												x				
	Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	50.000.00 Komuna, APK	Komuna, DB			x															x	
	Shenjëzimi i zonave të mbrojtura të natyrës	10.000.00 Komuna, IKMN	Komuna, DUMM			x								x								
	Zbatimi i Planit Hapësinorë për PK "Bjeshkët e Nemuna"	Komuna	Komuna, DUMM	x																		x
	Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Biodiveristetit	20.000.00 Komuna	Komuna, DUMM			x				x												
	Hartimi i Planit menaxhues për zonën e mbrojtur Burimin e Drinit të Bardhë dhe Shpellën e Radavcit	20.000.00 Komuna	Komuna, DUMM						x					x								
	Hartimi i planit komunal për turizëm të qëndrueshëm malor (ekoturizëm)	20.000.00 Komuna	Komuna, DUMM							X												
<b>Rritja e vetëdijësimit dhe edukimit për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës</b>	Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e mjedisit në shkolla të ulëta dhe të mesme	20.000.00 Komuna	Komuna, DUMM, DA	x																	x	
	Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit	20.000.00 Komuna	Komuna, DUMM,	x																		x
	Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e ujërave	20.000.00 Komuna	Komuna, DUMM, DSHP, KRU	x																		x

*Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028*

			HidroDrini																										
<b>Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për mbrojtjen e mjedisit</b>	Ndarja e subvencioneve për organizatat e shoqërisë civile të sektorit të mjedisit, organizatat e shoqërisë civile bjeshkatore, rekreative të cilat promovojnë mbrojtjen e mjedisit përmes aktiviteteve.	100.000.00 Komuna	Komuna				x																						
	Ndarja e buxhetit për punën e komitetit për mbrojtjen e mjedisit	50.000.00 Komuna	Komuna		x																							x	
	Fuqizimi i zbatimit të VSM dhe VNM në kuadër të planeve, programeve dhe projekteve komunale	Kosto administrative	Komuna		x																								
	Fuqizimi i bashkëpunimit me gjykatat, prokurorinë dhe Policinë e Kosovës për parandalimin e degradimit të mjedisit dhe natyrës	Kosto administrative	Komuna	x																									x
<b>Fuqizimi i kapaciteteve të komunës për mbrojtjen e mjedisit</b>	Rritja e numrit të inspektorëve të mjedisit	100.000.00 Komuna	Komuna, DI			x			X																				
	Rritja e buxhetit të komunës për mjedisit	Komuna	Komuna				x			x																			
	Trajnimi i zyrtarëve të sektorit të mjedisit të komunës	50.000.00 Komuna	Komuna, DUMM, DSHP		x																							x	

## 8. Plani i monitorimit të zbatimit të PLVM

**Tabela 21:** Plani i monitorimit për zbatimin e PLVM, indikatorët e suksesit dhe ndikimi i pritshëm

Nr.	Prioritetet	Aktivitetet	Indikatorët e Suksesit	Shpeshtësia e raportimit	Ndikimi i pritshëm
1.	<b>Mbrojtja e resurseve ujore dhe menaxhimi efikas i tyre</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ngritja e infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të zeza dhe atyre atmosferike për të gjitha vendbanimet e komunës.</li> <li>• Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura urbane në Terstenik</li> <li>• Rregullimi i shtretërve të lumenjëve për mbrojtje nga vërshimet dhe përmytjet</li> <li>• Zgjerimi i infrastrukturës për furnizim me ujë të pijes</li> <li>• Fushatë vetëdijësimi për mbrojtje nga përmytjet dhe vërshimet</li> <li>• Pjesëmarrja në zbatimin e veprimeve të Planit Menaxhues për Pellgun e Lumit Drini i bardhë</li> <li>• Fushatë vetëdijësimi për farmerët për reduktimin e ndotjes së ujërave nga bujqësia</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kilometrat e kanaleve (gypave) për grumbullimin e ujërave të zeza dhe atyre atmosferike/ Numri i vendbanimeve me infrastrukturë të rregulluar.</li> <li>• Kapacitetit i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura urbane në Terstenik;</li> <li>• Kilometrat e shtretërve të lumenjëve për mbrojtje nga vërshimet dhe përmytjet të rregulluar;</li> <li>• Gjatësia e gypave për furnizim me ujë të pijes të shtuar.</li> <li>• Numri i banorëve të vetëdijësuar/Numri i materialeve promovuese për mbrojtje nga përmytjet dhe vërshimet të shpërndara;</li> <li>• Numri i veprimeve të Planit Menaxhues për Pellgun e Lumit Drini i Bardhë të zbatuara;</li> <li>• Numri i fermerëve të vetëdijësuar/ Numri i materialeve promovuese për reduktimin e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vjetore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Gjashtëmujore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Gjashtëmujore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ujërat e zeza dhe atmosferike të grumbulluara si rezultat i ngritjes së infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të zeza dhe atyre atmosferike për të gjitha vendbanimet e komunës.</li> <li>• Ndotja e ujit e reduktuar si rezultat i funksionalizimit të impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura urbane në Terstenik.</li> <li>• Shtretërit e lumenjëve për mbrojtje nga vërshimet dhe përmytjet të rregulluara;</li> <li>• Furnizimi me ujë të pijes e përmirësuar si rezultat i rregullimit të infrastrukturës;</li> <li>• Vetëdijësimi për mbrojtje nga përmytjet dhe vërshimet e ngritur;</li> <li>• Cilësia e ujit e përmirësuar si rezultat i zbatimit të veprimeve të Planit Menaxhues për Pellgun e Lumit Drini i Bardhë;</li> <li>• Farmerët e vetëdijësuar për reduktimin e ndotjes së ujërave</li> </ul>

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028

			ndotjes së ujërave nga bujqësia të shpërndara;		nga bujqësia.
2.	<b>Përmirësimi i cilësisë së ajrit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Subvencionimi i familjeve për ndërrimin e lëndëve djegëse me ndotje të lartë me ato me ndotje të ulët</li> <li>• Subvencionimi i familjeve për ndërrimin e pajisjeve jo eficiente me ato eficiente</li> <li>• Subvencionimi i familjeve për ndërrimin e sistemeve të ngrohjes jo eficiente me ato eficiente</li> <li>• Hartimi i planit të mobilitetit për komunën e Pejës</li> <li>• Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve për zvogëlimin e emetimeve të pluhurit</li> <li>• Inventarizimi i burimeve të ndotjes siaps sektorëve në komunën e Pejës</li> <li>• Zbatimi i gjobave për djegiet e hapura të mbeturinave dhe djegiet tjera</li> <li>• Rritja e numrit të automjeteve të hibride dhe elektrike në flotën e komunës dhe në transportin publik</li> <li>• Mbështetja dhe subvencionimi i iniciativave për shfrytëzim të burimeve të ripërtristshme të energjisë</li> <li>• Hartimi i projektit për ndërtimin e rrjetit të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i familjeve për ndërrimin e lëndëve djegëse me ndotje të lartë me ato me ndotje të ulët të subvencionura;</li> <li>• Numri i i familjeve për ndërrimin e pajisjeve jo eficiente me ato eficiente të subvencionura;</li> <li>• Numri i familjeve për ndërrimin e sistemeve të ngrohjes jo eficiente me ato eficiente</li> <li>• Plani i mobilitetit për komunën e Pejës i hartuar dhe miratuar;</li> <li>• Sipërfaqet e rrugëve të pastruara nga pluhuri.</li> <li>• Burimet e ndotjes sipas sektorëve në komunën e Pejës të inventarizuara;</li> <li>• Numri i gjobave për djegiet e hapura të mbeturinave dhe djegiet tjera të zbatuara;</li> <li>• Numri i automjeteve hibride dhe elektrike në flotën e komunës dhe në transportin publik;</li> <li>• Numri i iniciativave për shfrytëzim të burimeve të ripërtristshme të energjisë të subvencionura;</li> <li>• Projektit për ndërtimin e rrjetit të ngrohjes qendrore për zonën urbane të qytetit i hartuar;</li> <li>• Numri i qytetravëve të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjashtëmujore</li> <li>• Gjashtëmujore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Tremujore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Gjashtëmujore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Vjetore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Cilësia e ajrit e përmirësuar si rezultat i reduktimit të ndotjes nga ndërrimin e lëndëve djegëse me ndotje të lartë me ato me ndotje të ulët.</li> <li>• Cilësia e ajrit e përmirësuar si rezultat i reduktimit të ndotjes nga ndërrimi i pajisjeve jo eficiente me ato eficiente;</li> <li>• Cilësia e ajrit e përmirësuar si rezultat i reduktimit të ndotjes si rezultat i ndërrimit të sistemeve të ngrohjes jo eficiente me ato eficiente;</li> <li>• Mobilitetit në komunën e Pejës i përmirësuar si rezultat i zbatimit të Plani i mobilitetit.</li> <li>• Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve për zvogëlimin e emetimeve të pluhurit</li> <li>• Inventarizimi i burimeve të ndotjes siaps sektorëve në komunën e Pejës i realizuar;</li> <li>• Reduktimi i ndotjes si rezultat i zbatimit të gjobave për djegiet e hapura të mbeturinave dhe djegiet tjera;</li> <li>• Rritja e numrit të automjeteve të hibride dhe elektrine në flotën e komunës dhe në transportin publik;</li> <li>• Burimet e ripërtristshme të</li> </ul>



Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028

		<p>ngrohjes qendrore për zonën urbane të qytetit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ngritja e vetëdijësimit dhe informimit për mbrojtje nga ndotja e ajrit dhe mbrojtjes së shëndetit nga ndotja</li> </ul>	<p>vetëdijësuar dhe informuar/Numri i materialeve promovuese të shpërndara;</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjashtëmujore</li> </ul>	<p>energjisë në dispozicion si rezultat i subvencionimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Projekti për ndërtimin e rrjetit të ngrohjes qendrore për zonën urbane të qytetit i përgatitur;</li> <li>Vetëdijësimi dhe informimi për mbrojtje nga ndotja e ajrit dhe mbrojtjes së shëndetit nga ndotja i përmirësuar;</li> </ul>
3.	<b>Reduktimi i zhurmës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i planit lokal për zhurmë</li> <li>Përcaktimi i zonave të zhurmës në zonën urbane të qytetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani lokal për zhurmë i hartuar dhe aprovuar;</li> <li>Numri i zonave të zhurmës në zonën urbane të qytetit të përcaktuara;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhurma e reduktuar si rezultat i zbatimit të planit lokal për zhurmë</li> <li>Standardet dhe normat e zhurmës të zbatuara në zonat përkatëse urbane të qytetit.</li> </ul>
4.	<b>Ndryshimet klimatike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i Planit Lokal për Energji dhe Klimë</li> <li>Zbatimi i veprimeve për zbutje të ndryshimeve klimatike nga Plani Lokal për Energji dhe Klimë</li> <li>Zbatimi i veprimeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike nga Plani Lokal për Energji dhe Klimë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani Lokal për Energji dhe Klimë i hartuar dhe aprovuar;</li> <li>Veprimet për zbutje të ndryshimeve klimatike nga Plani Lokal për Energji dhe Klimë të zbatuara;</li> <li>Veprimet për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike nga Plani Lokal për Energji dhe Klimë të zbatuara;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vjetore</li> <li>Gjashtëmujore</li> <li>Gjashtëmujore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aspektet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të adresuara përmes Planit Lokal për Energji dhe Klimë</li> <li>Emetimet e GHG të reduktuara si rezultat i zbatimit të veprimeve për zbutje të ndryshimeve;</li> <li>Zbatimi i veprimeve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në sektorët relevant;</li> </ul>
5.	<b>Shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës dhe përmirësimi i cilësisë së dheut</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rehabilitimi dhe rikultivimi i minierave të braktisura të shfrytëzimit të resurseve minerare;</li> <li>Mbrojtja e tokës nga erozioni;</li> <li>Rehabilitimi i hot-spotëve mjedisore nga ndotja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sipërfaqja e minierave të braktisura të rehabilituara dhe rikultivuara;</li> <li>Sipërfaqja e tokës së mbrojtur nga erozioni;</li> <li>Numri i hot-spotëve mjedisore nga ndotja industriale të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Minierat e braktisura të shfrytëzimit të resurseve minerare të rehabilituara;</li> <li>Tokat e mbrojtura nga erozioni;</li> <li>Hot-spotëve mjedisore nga ndotja industriale të rehabilituara;</li> </ul>

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028

		<p>industriale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i planit për mbrojtjen e tokës bujqësore me cilësi të lartë;</li> <li>Inventarizimi i burimeve të ndotjes së tokave;</li> <li>Mbështetja dhe subvencionimi i iniciativave për bujqësi organike dhe agroturizëm;</li> </ul>	<p>rehabilituara;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Plani për mbrojtjen e tokës bujqësore me cilësi të lartë i hartuar dhe aprovuar;</li> <li>Burimet e ndotjes së tokave të inventarizuara;</li> <li>Numri i iniciativave për bujqësi organike dhe agroturizëm të mbështetura;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> <li>Gjashtëmujore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Toka bujqësore me cilësi të lartë e mbrojtur si rezultat i zbatimit të planit për mbrojtjen e tokës;</li> <li>Burimet e ndotjes së tokave të inventarizuara;</li> <li>Bujqësia organike dhe agroturizëmi i zhvilluar si rezultat i mbështetjes dhe subvencionimit të iniciativave;</li> </ul>
<b>1.</b>	<b>Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rehabilitimi dhe zgjerimi i kapacitetit të deponisë sanitare të mbeturinave në Sferkë</li> <li>Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave;</li> <li>Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave;</li> <li>Menaxhimi (mbledhja) e mbeturinave në hapësira publike;</li> <li>Ngritja e infrastrukturës për ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave;</li> <li>Zbatimi i gjobave dhe masave ndëshkuese për hedhjen e pakontrolluar të mbeturinave;</li> <li>Promovimi i parimeve të ekonomisë qarkore në menaxhimin e mbeturinave;</li> <li>Fushatë vetëdijësimi për menaxhimin e mbeturinave komunale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Deponia sanitare e mbeturinave në Sferkë e zgjeruar dhe e rehabilituar;</li> <li>Numri i ekonomive familjare të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave;</li> <li>Numri i deponitë ilegale të mbeturinave të rehabilituara;</li> <li>Sipërfaqet (ha) të hapësira publike të mirëmbajtura nga mbeturinave;</li> <li>Numri i pajisjeve/infrastrukturës për ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave;</li> <li>Numri i gjobave dhe masave ndëshkuese për hedhjen e pakontrolluar të mbeturinave të zbatuara;</li> <li>Numri i fushatave për promovimin e parimeve të ekonomisë qarkore në menaxhimin e mbeturinave;</li> <li>Numri i popullsisë së vetëdijësuar/numri i</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> <li>Tremujore</li> <li>Vjetore</li> <li>Gjashtëmujore</li> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Deponimi i mbeturinave në deponinë sanitare të mbeturinave në Sferkë;</li> <li>Grumbullimi i mbeturinave komunale i përmirësuar;</li> <li>Zvogëlimi i mbeturinave në hapësira publike si rezultat i eliminimit të deponive ilegale të mbeturinave;</li> <li>Menaxhimi i mbeturinave në hapësira publike i përmirësuar</li> <li>Rritja e nivelit të ndarjes, riciklimit dhe kompostimit të mbeturinave;</li> <li>Reduktimi i mbeturinave si rezultat i zbatimit të gjobave dhe masave ndëshkuese;</li> <li>Parimet e ekonomisë qarkore në menaxhimin e mbeturinave të promovuara;</li> <li>Vetëdijësimi për menaxhimin e mbeturinave komunale i rritur si rezultat i zbatimit të fushatave.</li> </ul>

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028

			publikimeve dhe materialeve tjera promovuese;		
6.	<b>Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Marrja në mbrojtje e zonave të reja të natyrës;</li> <li>Revitalizimi i ekosistemeve natyrore të degraduara;</li> <li>Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura;</li> <li>Shenjëzimi i zonave të mbrojtura të natyrës;</li> <li>Zbatimi i Planit Hapësinorë për PK “Bjeshkët e Nemuna”;</li> <li>Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Biodiveristetit;</li> <li>Hartimi i Planit menaxhues për zonën e mbrojtur;</li> <li>Burimin e Drinit të Bardhë dhe Shpellën e Radavcit;</li> <li>Hartimi i planit komunal për turizëm të qëndrueshëm malor (ekoturizëm);</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i zonave të reja të natyrës të marra në mbrojtje</li> <li>Sipërfaqet e ekosistemeve natyrore të degraduara të revitalizuara;</li> <li>Sipërfaqet (ha) të zhveshura të pyllëzuara;</li> <li>Numri i zonave të mbrojtura të natyrës të shenjëzuara;</li> <li>Numri i akativateve të Planit Hapësinorë për PK “Bjeshkët e Nemuna” të zbatuara;</li> <li>Plani Lokal për Mbrojtjen e Biodiveristetit i hartuar dhe miratuar;</li> <li>Plani menaxhues për zonën e mbrojtur Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpellën e Radavcit i hartuar dhe miratuar;</li> <li>Plani komunal për turizëm të qëndrueshëm malor (ekoturizëm) i hartuar dhe miratuar;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vjetore</li> <li>Gjashtëmujore</li> <li>Gjashtëmujore</li> <li>Vjetore</li> <li>Gjashtëmujore</li> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> <li>Vjetore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit i përmirësuar si rezultat i marrjen në mbrojtje të zonave të reja të natyrës;</li> <li>Ekosistemeve natyrore të revitalizuara;</li> <li>Sipërfaqe te reja të pyjeve të pyllëzuara;</li> <li>Zonat e mbrojtura të shenjëzimi dhe informimi i përmirësuar;</li> <li>Planit Hapësinorë për PK “Bjeshkët e Nemuna” i zbatuar;</li> <li>Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit e përmirësuar si rezultat i zbatimit të Planit Lokal për Mbrojtjen e Biodiveristetit;</li> <li>Menaxhimi i zonës së mbrojtur Burimin e Drinit të Bardhë dhe Shpellën e Radavcit i përmirësuar;</li> <li>Turizmi i qëndrueshëm malor i promovuar;</li> </ul>
7.	<b>Rritja e vetëdijësimit dhe edukimit për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e mjedisit në shkolla të ulëta dhe të mesme;</li> <li>Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;</li> <li>Fushatë vetëdijësimi për</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i nxënësve/numri i shkollave/numri i publikimeve dhe materialeve tjera promovuese;</li> <li>Numri i popullsisë së vetëdijësuar për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit/numri i</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjashtëmujore</li> <li>Gjashtëmujore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit e vetëdijësuar për mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>Publiku u vetëdijësuar për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;</li> <li>Publiku i vetëdijësuar për mbrojtjen e ujërave;</li> </ul>

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Pejës 2024-2028

		mbrojtjen e ujërave.	publikimeve dhe materialeve tjera promovuese; <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i popullsisë së vetëdijësuar për mbrojtjen e ujërave/numri i publikimeve dhe materialeve tjera promovuese;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjashtëmujore</li> </ul>	
8.	<b>Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për mbrojtjen e mjedisit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndarja e subvencioneve për organizatat e shoqërisë civile të sektorit të mjedisit;</li> <li>• Ndarja e buxhetit për punën e komitetit për mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>• Fuqizimi i zbatimit të VSM dhe VNM në kuadër të planeve, programeve dhe projekteve komunale;</li> <li>• Fuqizimi i bashkëpunimit me gjykatat, prokurorinë dhe Policinë e Kosovës për parandalimin e degradimit të mjedisit dhe natyrës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i organizatave të shoqërisë civile të sektorit të mjedisit të subvencionuara;</li> <li>• Shuma e buxhetit të ndarë për punën e komitetit për mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>• Numri i planeve, programeve dhe projekteve ku është zbatuar VSM dhe VNM.</li> <li>• Numri i aktiviteteve të përbashkëta me gjykatat, prokurorinë dhe Policinë e Kosovës për parandalimin e degradimit të mjedisit dhe natyrës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjashtëmujore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Gjashtëmujore</li> <li>• Gjashtëmujore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Projektet e organizatave të shoqërisë civile për mjedisin të zbatuara.</li> <li>• Puna e komitetit për mbrojtjen e mjedisit e fuqizuar dhe më efikase;</li> <li>• Zbatimit i VSM dhe VNM në kuadër të planeve, programeve dhe projekteve komunale i fuqizuar;</li> <li>• Bashkëpunimi me gjykatat, prokurorinë dhe Policinë e Kosovës për parandalimin e degradimit të mjedisit dhe natyrës i fuqizuar;</li> </ul>
9.	<b>Fuqizimi i kapaciteteve të komunës për mbrojtjen e mjedisit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e numrit të inspektorëve të mjedisit</li> <li>• Rritja e buxhetit të komunës për mjedisit</li> <li>• Trajnimi i zyrtarëve të sektorit të mjedisit të komunës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i ri inspektorëve të mjedisit;</li> <li>• Shuma e buxhetit të komunës për mjedisit</li> <li>• Numri i zyrtarëve të sektorit të mjedisit të komunës të trajnuar/Numri i programeve të trajnimit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vjetore</li> <li>• Vjetore</li> <li>• Gjashtëmujore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Inspektimi i mjedisit i fuqizuar;</li> <li>• Numri i projekteve të reja për mjedisin nga buxheti i komunës;</li> <li>• Zyrtarët mjedisor të komunës të trajnuar për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi.</li> </ul>

## 9. Referencat dhe burimet e informacionit

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës (<https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/>)
2. Air Quality in Kosovo *Air Quality Portal (rks-gov.net)* <http://www.kosovo-airquality.com/secure/index2.html>.
3. ASK 2022, Vjetari Statistikor 2021
4. Raporti për gjendjen e natyrës 2010-2014, AMMK
5. DEMO për Mobilitetin Urban në Pejë
6. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/>)
7. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2026 për komunën e Pejës
8. Ligji (2009/03-L-025) për Mjedis
9. Ligji nr. 02 / l-102 për mbrojtjen nga zhurma
10. Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale
11. Ligji nr. 03/l-125 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
12. Ligji nr. 03/l-233 mbi mbrojtjen e natyrës
13. Ligji nr. 08/L-250 për ndryshime klimatike
14. Ligji nr.03/l-153 për pyjet e Kosovës
15. Ligji nr.04/l-147 për ujërat e Kosovës
16. Lista e Trashëgimisë kulturore për mbrojtje të Përkohshme Nr.110/2018 dhe Lista e TK për mbrojtje të Përhershme Nr.69/2016
17. Vlerat e Trashëgimisë Natyrore të Kosovës, MMPH/IKMN
18. Ndotja e ajrit në Kosovë, Masat dhe instrumentet e politikave të propozuara për të reduktuar ndotjen në sektorët kyç, AMMK, SEPA, IVL, 2023
19. Plani Hapësinorë i Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”, IPH/MMPH 2023
20. Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë 2018-2022 për Komunën e Pejës
21. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, Komuna e Pejës
22. Draft Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027, Komuna e Pejës
23. Plani Operativ Emergjent Lokal i Komunës së Pejës
24. Plani Regjional i Trashëgimisë 2012-2015 (Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë)
25. Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Pejës
26. Projekti për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës, MMPH/JICA
27. Projekti, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Cilësinë e Ajrit, ndryshimit të sjelljes dhe shërbimet e komunikimit: Azhurnimi i inventarit të emisioneve, MFK & AMMK 2021
28. Raport - Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve, AMMK 2022
29. Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2021, AMMK 2022
30. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2021, AMMK
31. Raporti i hotspoteve në Kosovë 2012
32. Raporti i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë për vitin 2020, AMMK 2021
33. Raporti i Performancës së KRU-2022, ARRU.

34. Raporti për gjendjen e mbeturinave komunale 2021, AMMK
35. Raporti për Gjendjen e Ujërave 2020, AMMK
36. Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2022, AMMK
37. Regjistrimi i Bujqësisë 2014, ASK
38. Regjistrimi i Popullsisë 2011, ASK
39. Sektori i biomasës drunore në Kosovë, Vështrim i integruar mbi kërkesën dhe ofertën për drurin si lëndë djegëse, FAO 2015
40. Statuti i Komunës së Pejës;
41. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Pejës
42. Studimi i Ndotjes së Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, MMPH/GIZ 2015;
43. Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë 2018-2019, ASK 2020
44. Vlerësim, Popullsia e Kosovës, ASK 2021.
45. [www.accursed-mountains.org](http://www.accursed-mountains.org)



<b>DATË/A</b>	<b>8/4/2024</b>
<b>REFERENCE</b>	
<b>PËR/ZA/TO</b>	Gazmend Muhaxheri, Kryetar Komuna e Pejës
<b>CC</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH</b>	
<b>NGA/OD/FROM</b>	Hajrije Haxhijaj, Zyrtare Kryesore Financiare Komuna e Pejës
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT</b>	Kërkesë për shtim të buxhetor

I nderuar z. Kryetar

Duke u bazuar në planin e të hyrave vetanake të komunës së Pejës në shumë prej 5,200,496.85 Euro për vitin 2023, komuna e Pejës e ka përmbushur planin dhe e kemi tejkalluar për shumën prej 1,007,040.75 Euro. Pra gjithsej të hyrat për vitin 2023 janë në shumë prej 6,207,537.60 Euro, pjesë e tejkallimit të planit janë të hyrat komunale, gjobat në trafik dhe gjobat nga gjykatat.

Tejkallimi i planit buxhetor në shumë prej 1,007,040.75 duhet të buxhetohet në dy programe buxhetore të kategorisë ekonomike të investimeve:

- a. Shuma prej 429,782.02 Euro duhet të buxhetohet në drejtorinë e Shërbimeve Publike, ndërsa;
- b. Shuma prej 577,258.73 Euro në drejtorinë për Kultur, Rini dhe Sport.

Shtojcë:

1. Tabela e gjendjes së realizimit e të hyrave vetanake në vitin 2023,
2. Tabela e shtimit të buxhetit në programe buxhetore të vitit 2023.

Me respekt,

2. Tabelori i shtimit të buxhetit ne programe buxhetore te vitit 2023

Kodi Funkcional	Kodi I nënprogramit	Kodi i Projektit	Emri i Projektit	SHUMA
<b>635</b>				<b>1,007,040.75</b>
<b>180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia</b>				<b>429,782.02</b>
<b>18019 - Infrastruktura Rrugore - Peje</b>				<b>429,782.02</b>
,0451	18019	54629	Ndertimi i Sheshit Hotel Korze - Ura e zallit	429,782.02
<b>850 - Kulturë, Rini, Sport</b>				<b>577,258.73</b>
<b>85019 - Shërbimet Kulturore - Peje</b>				<b>577,258.73</b>
,0820	85019	49924	Ndërtimi i Fushës së Futbollit në Fshatin Baran	165,812.38
,0820	85019	46455	Renovimi i Muzeut dhe Teatrit	<b>111,446.35</b>
,0820	85019	53046	Ndërtimi i palestres në Zahaq	300,000.00
<b>TOTALI</b>				<b>1,007,040.75</b>





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS    MUNICIPALITY OF PEJA    OPŠTINA PEĆ

<b>DATË/A</b>	<b>8 Prill 2024</b>
<b>REFERENCE</b>	
<b>PËR/ZA/TO</b>	Gazmend Muhaxheri Kryetar i Komunës Komuna Pejë
<b>CC</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH</b>	
<b>NGA/OD/FROM</b>	Hajrije Haxhijaj Zyrtare Kryesore Financiare Komuna Pejë
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT</b>	Kërkesë për rialokim

I nderuari z. Kryetar,

Të hyrat vetanake të cilat duhet të barten në vitin 2024 janë në shumën 592,286.43€ si të hyra të pa shpenzuar të vitit 2023, sipas Ligjit të buxhetit 08/L-260 neni 9 paragrafi 6 të hyrat barten në kategori dhe projekte në vitin 2024 nga Ministria e Financave Punë dhe Transfereve, gjegjësisht Departamenti i Buxhetit dhe Departamenti i Thesarit, të cilët bartjen e bëjnë në mënyrë direkte duke mos ndryshuar strukturën e shpenzimeve.

Meqenëse kemi mungesë të fondeve në projektet të caktuara, për të mundësuar sigurimin e mjeteve për implementimin e projekteve kapitale, ne duke u bazuar në Ligjin 03/L-048 neni 30 paragrafi 1 si dhe Ligjit 08/L-260 neni 15 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024, i rekomandojmë kuvendit komunal që të aprovoje ri' alokimin e mjeteve në shumë prej 102,810 Euro, si ne vijim:

- Rekomandimi që shuma prej 102,810.00 Euro në drejtorinë për Kultur, Rini dhe Sport me numër të programit 85019, duhet të ri' alokohet në të njëjtin program në projektet e vitit 2023 dhe 2024, dhe

**Nga të hyrat vetanake fondi burimor (22)**

Nga drejtoria për Kultur Rini dhe Sport, projekti me numër 52692 "Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit në palestrën Karagaq" shuma prej 102,810.00€ duhet të ri' alokohet në të njëjtin drejtori në projektet si më poshtë:

- Në projektin 52688 “Rregullimi i Galerisë së Arteve ” shuma prej 62,848.00 € dhe
- Në projektin 54420 “Blerja e arenës profesionale për boks si dhe skenës profesionale për ambiente të hapurave’ ne shume prej 39,312.00€

Me respekt,



## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI

### Projekti “Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim”

Ky projekt do të realizohet sipas Thirrje Publike të datës 08.04.2024 - **Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim.**

**Për implementimin e këtij projekti**, ku Komuna do të mbështesë fermerët më 70% të vlerës së përgjithshme ndërsa fermeri do të participojë më 30%.

Qëllimi i këtij projekti është mbështetje e qëndrueshme e ekonomisë familjare në zonat rurale të Komunës së Pejës.

Subvencionimi përfshinë:

1. Freza 1.8m – 40 përfitues;
2. Freza 2.0m – 20 përfitues;
3. Makina mbjellëse për misër 4 rendëshe pneumatike – 6 përfitues;
